

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6035  
E premte, 12 qershor 2020  
çmimi 0.40 €

## IKShPK-ja pranon 15 000 teste për Covid-19



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI

# NËSE BISEDONHET PËR TRAKTAT PAQEJE, PRESIDENTI I PRIN PROCESIT



Politologu Ramush Tahiri ka thënë se nëse Kosova me Serbinë zhvillojnë bisedime për një traktat paqeje, procesin e dialogut do ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçi.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo është e përcaktuar me Kushtetutë. Sipas tij, kjo nuk do ta përjashtojë kryeministrin dhe qeverinë nga procesi i këtij dialogu. Tahiri ka deklaruar se nëse procesi do të jetë vetëm për njohje reciproke, procesin mund ta drejtojë kryeministri i Kosovës

## THAÇI PËR DIALOGUN: PRESIDENTI E PËRFAQËSON VENDIN EDHE NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR



Lidhur me debatin e krijuar së fundmi, se kush do ta udhëheqë dialogun Kosovë - Serbi, presidenti i Kosovës apo kryeministri, Hashim Thaçi ka thënë të enjten se këtë proces do ta udhëheqin përfaqësuesit legjitimë të

Kosovës. "Ne nuk jemi në garë me njëri-tjetrin, por do ta plotësojmë njëri-tjetrin. Ne edhe të bashkuar do të përballemi me vështirësi dhe pengesa të mjaftueshme. Presidenti i vendit e përfaqëson vendin në rraf-

shin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Gjithçka shtë e përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës dhe kompetencat janë të qarta. Në këtë drejtim nuk ka asnjë dilemë", ka deklaruar Thaçi



## NË GJASHTËVJETORIN E NDARJES NGA JETA PËRKUJTOHET AKTIVISTI ARBËNOR DEHARI

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### OPINION

## KOSOVA EUROATLANTIKE MERITON UNITET NDËRMJETËSIMI BE - SHBA

F. 8

Prof. Lisen  
BASHKURTI



## PREKAZI DHE ADEMI

F. 11

Bedri  
ISLAMI



### AKTUALE



## SABRI FEJZULLAHU NDEROHET ME ÇMIMIN 'ÇELËSI I QYTETIT' NGA KOMUNA E PRISHTINËS

F. 10

## FAUCI, OPTIMIST PËR ZBULIMIN E VAKSINËS KUNDËR KORONAVIRUSIT

F. 2

### EKONOMI

## KUVENDI MIRATON PROPOZIMIN E QEVERISË PËR TEJKAJIM TË DEFICITIT BUXHETOR

F. 9

## GJYKATAT KANË KAPACITETET E DUHURA PËR T'I TRAJTUAR ÇËSHTJET E FALIMENTIMIT

F. 9

### SPORT

## MILICAJ, FERONIKELIT: MOS EJA NË KLINË PËR FITORE

F. 24



# Cakaj: Vazhdojmë qasjen e bashkërenduar në të mirë të Luginës e të shqiptarëve

BUJANOC, 11 QERSHOR (ER) - Gjatë qëndrimit zyrtar në Luginën e Preshevës, ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka zhvilluar të enjten edhe një takim me kryetarin e Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi. Ministri në detyrë, Cakaj, ka bërë me dije se me kryetarin e Komunës së Bujanocit ndanë të njëjtën bindje, atë të bashkimit të brendshëm të faktorit shqiptar, si një parakusht i forcimit të tij. "Ndaj do të

vazhdojmë me qasje të bashkërenduar e me bashkëpunim sistematik në të mirë të Luginës e shqiptarëve në përgjithësi", u shpreh Cakaj. Sipas kryediplomatit Cakaj, edhe pse ka disa parti politike shqiptare, duhet të ketë vetëm një faktor politik shqiptar. Më tej, ministri në detyrë, Cakaj, vizitoi edhe disa vende me rëndësi të veçantë për zhvillimin e qytetit, për të cilat u zotua se do ta kenë mbështetjen e qeverisë shqiptare pa kursim.



## Fauci, optimist për zbulimin e vaksinës kundër koronavirusit



WASHINGTON, 11 QERSHOR - Një nga ekspertët kryesorë për koronavirusin në Shtetet e Bashkuara, Anthony Fauci, ka thënë se është optimist se vaksina kundër Covid-19 mund të gjendet në kohë rekorde. Duke folur në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Fauci, drejtor i Institutit Kombëtar të ShBA-së për Alergjji dhe Sëmundje Infektive, ka theksuar se provat e hershme të disa vaksinave kanë qenë

pozitive.

Kompania amerikane "Moderna" ka testuar tashmë një vaksinë eksperimentale dhe ka thënë se ajo ka dhënë shenja premtuese. "Po, jam optimist se do të kemi vaksinë brenda një periudhe të arsyeshme kohore jo vetëm nga kompania 'Moderna', por edhe nga të tjera. Jemi të përfshirë në bashkëpunim me disa kompani. Arsyeja që jam optimist është se në provat e

hershme të njerëzimit dhe të kafshët, rezultatet kanë qenë të favorshme. Nëse kemi vaksinë të suksesshme, mendoj se shumica e njerëzve do ta marrin, qoftë përmes zyrës së mjekut të tyre, përmes farmacive apo qendrave të shpërndarjes", ka deklaruar Fauci.

Dhjetëra kompani farmaceutike janë në garë për gjetjen e vaksinës kundër koronavirusit, i cili ka prekur mbi 7.4 milionë njerëz në botë.

## OBSH-ja paralajmëron Shqipërinë: Nuk po respektohen masat, vendi rrezikon të mbyllet sërish

TIRANË, 11 QERSHOR - Rastet e shtuara të Covid-19 në Shqipëri po shihen me shqetësim edhe nga përfaqësuesja e OBSH-së në këtë vend, Bettina Menne. Në një intervistë për Tv Klan, Menne ka theksuar se masat e ndërmarra në fillim të pandemisë ishin pozitive, por mosrespektimi i tyre mund ta rikthejë karantinën. "Jam shumë e lumtur që vendi juaj është hapur sërish, por epidemia nuk ka mbaruar dhe ajo që ne shohim është rritja e rasteve, që do të thotë se të afërmit tuaj mund të infektohen. Ne rekomandojmë

që i gjithë stafi që punon në spital dhe mund të ketë kontakt me persona të infektuar, duhet të vendosë maskë dhe, po ashtu, në transport publik si dhe në bare e restorante që nuk ka 1.5 metër distancë fizike, përndryshe do t'u duhet ta mbyllni edhe një herë vendin. Por a e imagjinoni dot? Vendi duhet të zhvillohet, ekonomia po ashtu. Është përgjegjësi sociale e të gjithëve. Autoritetet dhe kompanitë duhet ta shmangin infektimin që të mos bëhet më mbyllje dhe marrje masash strikte edhe një herë", ka deklaruar ajo.



Përfaqësuesja e OBSH-së në Shqipëri ka thënë se, përveç protestave të organizuara në Tiranë, tashmë po vihen re edhe

grumbullime nga vetë njerëzimit në bare dhe restorante. "Ti shikon në çdo vend të madh në Tiranë, shikon në bare dhe

restorante ku distanca fizike nuk respektohet. Duhet të bëhet shumë kujdes në transportin publik, në respektimin e rregullave. E di që hapja e tij është një lajm i mrekullueshëm, por kjo do të varet nga çdo qytetar që do ta përdorë transportin publik dhe nga kompanitë që kanë autobusët, pasi duhet ta bëjnë dezinfektimin", ka deklaruar Menne. Ajo ka rekomanduar përdorimin e maskave nga të gjithë kategoritë shoqërore si dhe bluzat e bardha për frenimin e përhapjes së Covid-19.

## Shtyhet mbajtja e zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka vendosur që t'i shtyjë

zgjedhjet e jashtëzakonshme në Mitrovicën e Veriut për një afat të pacaktuar për shkak të sit-

uatës me Covid-19. Kryetari i deritanishëm, Goran Rakiq, është emëruar zëvendëskryeministër

dhe ministër i Pushtetit Lokal në qeverinë Hoti dhe për këtë arsye në Mitrovicën e Veriut do të

duhej të mbaheshin zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të kësaj komune.



# Thaçi për dialogun: Presidenti e përfaqëson vendin edhe në rrafshin ndërkombëtar

**EPOKA E RE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të enjten se ende nuk ka një njoftim zyrtar nëse përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, do ta vizitojë Kosovën javën e ardhshme.

I pyetur nga gazetarët nëse do ta takojë Lajçakun, presidenti Thaçi ka thënë se për Kosovën është me rëndësi që përfaqësuesit ndërkombëtarë, që merren me çështjen e dialogut, ta trajtojnë Kosovën si një vend të pavarur dhe sovran. Sipas Thaçit, çdo qasje tjetër ndaj Kosovës është e dështuar. "Nuk ka kohë tani për matje të pulseve apo për trajtime seminari të çështjes së Kosovës për njohje reciproke Kosovë - Serbi, por është (v.j. koha) për vendimmarrje historike që sjell rezultate konkrete", ka deklaruar Thaçi.

Lidhur me debatin e krijuar së



Lidhur me debatin e krijuar së fundmi, se kush do ta udhëheqë dialogun Kosovë - Serbi, presidenti i Kosovës apo kryeministri, Hashim Thaçi ka thënë të enjten se këtë proces do ta udhëheqin përfaqësuesit legjitimë të Kosovës. "Ne nuk jemi në garë me njëri-tjetrin, por do ta plotësojmë njëri-tjetrin. Ne edhe të bashkuar do të përballemi me vështirësi dhe pengesa të mjaftueshme. Presidenti i vendit e përfaqëson vendin në rrafshin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Gjithçka është e përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës dhe kompetencat janë të qarta. Në këtë drejtim nuk ka asnjë dilemë", ka deklaruar Thaçi

fundmi, se kush do ta udhëheqë dialogun Kosovë - Serbi, presidenti i Kosovës apo kryeministri, Thaçi ka theksuar se atë do ta udhëheqin përfaqësuesit legjitimë të Kosovës. "Ne nuk jemi në garë me njëri-tjetrin, por do të plotësojmë njëri-tjetrin. Ne edhe të bashkuar do të përballemi me vështirësi dhe pengesa të mjaftueshme.

Presidenti i vendit e përfaqëson vendin në rrafshin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Gjithçka është e përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës dhe kompetencat janë të qarta. Në këtë drejtim nuk ka asnjë dilemë", ka shtuar mes tjerash ai. Një ditë më parë kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se dialogu me Serbinë do të udhëhiqet nga kryeministri i

vendit. "Dialogun e udhëheq kryeministri i Kosovës. Ka pasur diskutime të ndryshme javët dhe muajt e fundit. Unë nuk do të bëj kurrfarë gare me bartësit e tjerë institucionalë, pasi kompetencat e mia kushtetuese janë të qarta, përfshirë edhe kompetencat për dialog", ka deklaruar Hoti.

Ai ka përmendur tri parimet bazike që do ta udhëheqin

Kosovën në procesin e dialogut. "Parimi i parë është që integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i panegociueshëm. Unë nuk dua as si qytetar, as si kryeministër dhe as nuk kam mandat të diskutoj për integritetin territorial të Republikës së Kosovës. E dyta, në marrëveshjen që duhet të arrihet për normalizim të marrëdhënieve për njohje reciproke, e cila duhet të sigurojë se konflikti në mes të Kosovës dhe Serbisë zhduket një herë e përgjithmonë. Parimi i dytë është që organizmi kushtetues dhe shtetëror i Kosovës është i panegociueshëm. Nuk ka pushtet të ndërmjetëm. Dhe parimi i tretë, marrëveshja që duhet të arrihet, duhet të jetë në përputhje me frymën e

Kushtetutës së Kosovës", ka thënë Hoti gjatë prezantimit të kornizës së qeverisë për dialogun me Serbinë në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Akademikët e Kosovës kanë kërkuar që institucionet e Kosovës të arrijnë një konsensus nacional për dialogun me Serbinë i cili pritet të rifillojë së shpejti. Ndërkaq, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, derisa ka uruar të mërkurën Avdullah Hotin për zgjedhjen kryeministër i Kosovës, ka thënë se qeveria e re ka ardhur në çaste kyçe për Kosovën, veçanërisht për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Macron ka theksuar se Franca dhe Gjermania janë angazhuar për rifillimin e dialogut i cili do të mund të fillojë gjatë një samiti të ardhshëm në Paris.

## Quinti u kërkon udhëheqësve të Kosovës të përmbahen nga gjuha nxitëse



**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Përfaqësuesit e vendeve të Quintit u kanë bërë thirrje udhëheqësve politikë të Kosovës që të diskutojnë për sfidat dhe mundësitë e Kosovës "pa fyerje dhe kërcënime". Ata nuk iu referuan ndonjë rasti të veçantë, por thanë se "çdo formë e gjuhës nxitëse, në veçanti sulmet personale që synojnë promovimin e objektivave politike, mund të kontribuojnë në një atmosferë

që inkurajon akte dhune". "U bëjmë thirrje udhëheqësve politikë të Kosovës të diskutojnë lidhur me sfidat dhe mundësitë e shumta me të cilat përballlet Kosova pa fyerje dhe kërcënime. E ardhmja demokratike e Kosovës varet nga zgjuarsia e udhëheqësve të saj për të vënë një shembull pozitiv të diskursit shoqëror dhe respektimin e lirisë së shprehjes. Çdo formë e gjuhës nxitëse, në veçanti sulmet personale që synojnë promovimin e objektivave politike, mund të kontribuojnë në një atmosferë që inkurajon

akte dhune. Qytetarët e Kosovës meritojnë më mirë", thuhet në deklaratën e Quintit.

Vendet e Quintit përfshijnë: Shtetet e Bashkuara, Britaninë e Madhe, Francën, Gjermaninë dhe Italinë.

Ditët e fundit përfaqësues të caktuar politikë në Kosovë, në intervista dhe prononcime të ndryshme, kanë sulmuar verbalisht kundërshtarët politikë të cilët janë përgjigjur në mënyra të ngjashme. Në shumë raste nuk kanë munguar fjalori fyes dhe gjuha denigruese.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, RAMUSH TAHIRI

# NËSE BISEDOKET PËR TRAKTAT PAQ

Politologu Ramush Tahiri ka thënë se nëse Kosova me Serbinë zhvillojnë bisedime për një traktat paqesje, procesin e dialogut do ta udhëheqë presidenti Hashim Thaçi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se kjo është e përcaktuar me Kushtetutë. Sipas tij, kjo nuk do ta përjashtojë kryeministrin dhe qeverinë nga procesi i këtij dialogu. Tahiri ka deklaruar se nëse procesi do të jetë vetëm për njohje reciproke, procesin mund ta drejtojë kryeministri i Kosovës

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

presidentëve do të mund të fillojnë në muajin tetor.

**PRISHTINË, 11 QERSHOR** - Politologu Ramush Tahiri ka bërë me dije se natyra e dialogut që Kosova do të bëjë me Serbinë do ta caktojë edhe udhëheqësin e këtij procesi. Ai ka treguar se nëse ky proces do të jetë teknik, atë do ta udhëheqë qeveria.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Tahiri ka treguar se nëse dialogu do të jetë për ndonjë traktat të paqes, procesi do të udhëhiqet nga presidenti i vendit. “Nëse me dialog kuptojmë bisedimet për njohje reciproke, shkëmbimin e notave diplomatike, me të cilat do të njiheshin Kosova nga Serbia, atëherë kjo është punë e qeverisë. Por, nëse do të ketë dialog për paqe, për marrëveshje gjithëpërfshirëse, atëherë kjo është punë edhe e presidentit. Këtu qeveria nuk përjashtohet, por kyçet edhe presidenti i vendit”, ka thënë Tahiri.

Ai ka deklaruar se Kosova nuk duhet të hyjë në dialog për marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë. Sipas Tahirit, hyrja e Kosovës në një proces të tillë do të ishte e rrezikshme. “Kosova asnjëherë nuk duhet të hyjë në bisedime me Serbinë duke mos e pranuar kufirin që ekziston tani. Kosova në bisedime me Serbinë duhet të hyjë me kufij të qartë, si një subjekt ndërkombëtar. Nëse Kosova hyn në bisedime për kufij pa u njohur nga Serbia, atëherë Kosova faktikisht e mohon vetveten. Mirëpo në opinion liderët tanë, fatkeqësisht, po thonë se na duhet një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë. Pra, po përdorim terminologji të gabueshme në raport me dialogun me Serbinë”, ka thënë ai. Tahiri ka paralajmëruar se dialogu teknik në mes të dy vendeve do të rifillojë këtë muaj. Ai ka deklaruar se takimet në mes të dy

“**Epoka e re**”: Z. Tahiri, presidenti dhe kryeministri po pretendojnë të dy se do ta udhëheqin procesin e dialogut me Serbinë. Kush mendoni se duhet ta udhëheqë këtë proces?

**Tahiri:** Pavarësisht prej deklarimeve të tyre, mendoj se të dy thirren në Kushtetutën e Kosovës. Këtu keqkuptimi është se çka nënkuptohet me dialog. Nëse me dialog kuptojmë bisedimet për njohje reciproke, shkëmbim të notave diplomatike, me të cilat do të njiheshin Kosova nga Serbia, atëherë kjo është punë e qeverisë. Por, nëse do të ketë dialog për paqe, për marrëveshje gjithëpërfshirëse, atëherë kjo është punë edhe e presidentit. Këtu qeveria nuk përjashtohet, por kyçet edhe presidenti i vendit. Në Kosovë është krijuar një opinion që disa vite se bisedimet duhet t'i udhëheqë ose kryeministri ose presidenti. Ky mendim është i politizuar dhe i pasaktë. Në Kushtetutë dhe ligje kjo çështje është e qartësuar. Pra, Kushtetuta ua ka caktuar përgjegjësitë qeverisë dhe presidentit. Dihet se nëse një proces e udhëheq kryeministri, presidenti nuk shkon. Ndërsa kur një proces udhëhiqet nga presidenti, kryeministri mund të shkojë, sepse edhe në takime multilaterale ku janë të dy liderët institucionale, presidenti flet i pari dhe pas tij flet kryeministri.

“**Epoka e re**”: A do të duhej që presidenti dhe kryeministri ta qartësojnë këtë polarizim?

**Tahiri:** Ky polarizim është i panevojshëm. Presidenti ka të drejtë kur thotë se kur ta thërrasin atë në dialog ai do të shkojë, sepse ata që i thërrasin liderët institucionale të Kosovës e dinë se kush iu duhet dhe për çka iu duhet. Problemi te ne është se nuk po dihet se çka është dialogu. Këtu secili



po flet sipas mënyrës së vet, pa e kuptuar mirë dialogun se për çka do të bisedohet. Ajo që dihet është se deri më tani bisedimet e Brukselit i ka nënshkruar vetëm Qeveria e Kosovës dhe jo presidenti. Presidenti nuk ka shkuar në Bruksel për dialog. Dialogu në mes të dy vendeve nuk është zhvilluar asnjëherë në nivel të presidentëve. Nëse bëhet një marrëveshje e paqes, pse po dëshiron dikush ta largojë presidentin Thaçi. Nëse dikush nuk e do Thaçin, atëherë le ta largojnë dhe ta zgjedhin dikë tjetër president. Sepse institucioni i presidentit është unifikuar dhe e përfaqëson vendin brenda dhe jashtë. Dihet që presidenti nënshkruan disa traktate ndërkombëtare të cilat janë të numëruara në Kushtetutë dhe ku përfshihet edhe traktati i paqes. Pra, ndryshe është kur të thuhet se po bisedohet për marrëveshje gjithëpërfshirëse apo pa marrëveshje të paqes, e ndryshe është kur të thuhet se po bisedohet për njohje

bilaterale për njohje reciproke.

“**Epoka e re**”: Kryeministri Hoti ia ka prezantuar ASHAK-ut kornizën për dialogun me Serbinë. Si e keni parë këtë kornizë?


**Tahiri:** Kryeministri Hoti po tenton të bëjë forum të liderëve partiakë, grupe të ekspertëve dhe komision parlamentar. Mendoj se ai nuk mund t'i bëjë të gjitha këto sepse nuk është në kompetencën e tij. Ai nuk mund të kërkojë që krahas qeverisë të punojë edhe me liderët e partive politike. Këto mund ta bëjë presidenti e jo kryeministri. Edhe ish-kryeministri Kurti e pati planifikuar një grup ku presidentin e kishte lënë pas kryeministrin. Kjo nuk shkon askund.

“**Epoka e re**”: Përveç faktorëve politikë vendorë, edhe partnerët ndërkombëtarë të Kosovës po deklarojnë se të dyja vendet do të bisedojnë për një marrëveshje historike ligjrisht të obligueshme.

**Tahiri:** Tani e kemi përvjetorin e Marrëveshjes së Kumanovës ku ushtria e ish- Jugosllavisë ka kapitulluar. Ajo ka qenë marrëveshje e paqes. Çfarë marrëveshje të paqes po duam ne sot ta bëjmë me Serbinë. Kosova nuk mund të bëjë marrëveshje paqe me Serbinë sepse Kosova nuk i ka shpallur luftë asnjëherë Serbisë. Ne nuk kemi një akt të një institucioni të Kosovës që i ka shpallur luftë Serbisë. Ne çdo herë kemi thënë se lufta e UÇK-së ka qenë luftë për çlirim dhe liri. Besoj se Kosova nuk ka nevojë për bisedime të tilla me Serbinë. Ne me Serbinë duhet të flasim për vendosje të marrëdhënieve diplomatike dhe përmes atyre marrëdhënieve diplomatike do të na njohë Kosovën. Në këtë mënyrë do të veprojmë me të gjitha shtetet e tjera që nuk na kanë njohur ende. Ne i kemi dikur rreth 300 marrëveshje me të gjitha shtetet që na kanë njohur, të cilat i ka bërë qeveria, përkatësisht ministrinë adekuate. Nëse nënshkruhet



# EJE, PRESIDENTI I PRIN PROCESIT



drejt një marrëveshje gjithëpërfshirëse për mbylljen e konfliktit.

Ne nuk kemi nevojë për një proces të ri me Serbinë. Kosova ka pasur një dialog teknik me Serbinë për t'i arritur disa marrëveshje konkrete. Në këtë proces i kemi arritur 36 marrëveshje, 33 në Bruksel dhe tri që i bëri ambasadori Grenell. Nëse mendohet se me Serbinë do të bëhet marrëveshje për reparacione të luftës, e kemi gabim. Sepse këtë nuk e ka bërë as Bosnja, as Kroacia e as Sllovenia ngaqë nuk është pajtuar Serbia me këtë. Pra, me Serbinë nuk na duhet kurrfarë bisedimesh

gjithëpërfshirës, por bisedime konkrete për çështje konkrete.

**“Epoka e re”:** Kur prini se do të rifillojë dialogu?

**Tahiri:** Besoj se dialogu teknik në mes të dy qeverive do të rifillojë në muajin qershor. BE-ja është vetëm lehtësuese në këtë proces sepse nuk arbitron në proces. Ky proces do të rifillojë shpejt. Nuk besoj se do të shkojë z. Hoti në këtë proces, por dikush prej qeverisë, ku do të diskutohet për zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri më tani dhe për temat e reja. Me siguri se do të diskutohet për këto tri marrëveshje që janë

arritur me ndërmjetësimin e ambasadorit Grenell.

**“Epoka e re”:** Po dialogu i paralajmëruar për marrëveshjen historike, kur mund të fillojë?

**Tahiri:** Takimet politike mes presidentëve pa ndonjë agjendë nuk besoj se mund të fillojnë para muajit tetor. Ato takime nuk besoj se do t'i pengojnë marrëveshjet që mund t'i bëjë qeveria në Bruksel. Po e përsëris edhe një herë, mendoj se Kosova nuk duhet të ketë aso lloj bisedimesh me Serbinë sepse ne luftën e kemi përfunduar në vitin 1999.

## LV-ja dorëzon në Kushtetuese kërkesën për rastin e votimit të qeverisë Hoti nga deputeti Etem Arifi

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje të enjten ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për, siç thotë, antikushtetueshmërinë e pjesëmarrjes dhe të votimit të deputetit Etem Arifit për qeverinë Hoti. “Më 3 qershor në seancën e Kuvendit të Republikës, në të cilën u votua qeveria ilegale dhe kundër vullnetit të votuesve, mori pjesë edhe deputeti i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale me një vit e tre muaj burg. Pjesëmarrja e z. Etem Arifi në seancë dhe votimi i tij, aq më tepër si votë përcaktuese, e thellon edhe më shumë

paligjshmërinë e kësaj qeverie dhe e bën edhe proceduralisht të paligjshëm vendimin e Kuvendit për votimin e qeverisë. Është e përcaktuar qartë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, se mandati i deputetit humbet ose bëhet i pavlefshëm në rast të dënimit për vepër penale me një vit e më shumë burg”, është thënë në njoftimin e LV-së.

Lëvizja Vetëvendosje ka theksuar se pa bazë kushtetuese dhe pa vullnetin e votuesve, e varur plotësisht nga Lista Serbe, madje me vota të deputetëve përkundër vullnetit të tyre, ajo është e pavlefshme edhe ligjërisht prej

votimit të Etem Arifit si i dënuar me vendim përfundimtar gjyqësor për vepër penale. “Me provat që dëshmojnë qartazi se z. Etem Arifi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe për rrjedhojë ka humbur mandatin e deputetit, sot disa deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kanë dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për antikushtetueshmërinë e pjesëmarrjes dhe të votimit të z. Arifi, i cili e bën të pavlefshëm dhe jokushtetues vendimin e Kuvendit të Kosovës”, thuhet në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.

marrëveshja e paqes, atëherë duhet të hyjë edhe amnistia. Ndërsa, nëse nënshkruhet marrëveshje për njohje, atëherë automatikisht Kosova e ka kufirin me Serbinë. Institucionet tona nuk do të duhej ta ndjekin idenë e Vuçiqit i cili po thotë se me shqiptarët kemi luftuar me qindra vjet dhe tani duhet të bëjmë paqe. Ai nuk po thotë me Kosovën, por me gjithë shqiptarët.

**“Epoka e re”:** A duhet Kosova të hyjë në këto bisedime?

**Tahiri:** Kosova asnjëherë nuk duhet të hyjë në bisedime me Serbinë duke mos e pranuar kufirin që ekziston tani. Kosova në bisedime me Serbinë duhet të hyjë me kufij të qartë, si një subjekt ndërkombëtar. Nëse Kosova hyn në bisedime për kufij pa u njohur nga Serbia, atëherë Kosova faktikisht e mohon vetveten. Mirëpo në opinion liderët tanë, fatkeqësisht, po thonë se na duhet një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë. Pra, po përdorim terminologji

të gabueshme në raport me dialogun me Serbinë.

**“Epoka e re”:** Në bazë të përgatitjeve që kanë bërë ShBA-ja dhe BE-ja për këtë proces, nga cili lloj i dialogut po shkon Kosova? Nga dialogu për një traktat paqesje me Serbinë apo nga një marrëveshje për njohje bilaterale?

**Tahiri:** Fatkeqësisht, nga viti 2011 e këndej Serbia është në avantazh ndaj Kosovës. Ajo ka arritur të bëjë konferencë statusore, pra ka arritur të bisedojë për statusin e Kosovës. Në marrëveshjen për fusnotën kemi bërë hapa mbrapa në këtë drejtim, ani pse e kemi pasur mendimin e Gjykatës së Drejtësisë në favor të pavarësisë. Tani Serbisë po i konvenon një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Kosovën sepse një marrëveshje e tillë përfshin mbylljen e konflikteve. Kosova nuk ka nevojë për një marrëveshje të tillë. Pra, ndërmjetësimin që po dëshiron ta bëjnë ShBA-ja dhe BE-ja është fakt se po na dërgojnë





# ShBA-ja ndihmon personelin shëndetësor në Kosovë me pajisje mbrojtëse profesionale

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë ka pranuar të enjten një donacion me pajisje mbrojtëse profesionale për personelin shëndetësor (maska kirurgjikale, FFP2 - maska respirator, veshje mbrojtëse, mbrojtëse për fytyrë, dorëza të formateve të ndryshme, mbulesa

për shtretër) nga Ambasada Amerikane, përkatësisht nga programi i Ndhmës Humanitare i Komandës Evropiane të ShBA-së.

Donacioni është dorëzuar nga majorja Courtney R. Olson e Ushtrisë Amerikane, udhëheqëse e Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes nga Ambasada e ShBA-së në Prishtinë, ndërsa është pranuar



nga drejtori i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësore në MSh, dr. Arsim Qavdarbasha. Donacioni është një përkrahje e

drejtëpërdrejtë për MSh-në dhe personalin shëndetësor në ballafaqim me Covid-19. MSh-ja ka falënderuar autoritetet


amerikane për këtë donacion, për bashkëpunimin dhe mbështetjen e sistemit shëndetësor në Kosovë.

# Në gjashtëvjetorin e ndarjes nga jeta përkujtohet aktivisti Arbënor Dehari

PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, së bashku me aktivistë të kësaj lëvizje, kanë bërë homazhe me rastin e 6-vjetorit të ndarjes nga jeta të aktivistit Arbënor Dehari. "Sot Arbënor do të kishte qenë 35-vjeçar me plot angazhim e përkushtim, mendim dhe entuziazëm për vetëvendosjen e popullit tonë,

për barazi shoqërore dhe për zhvillim ekonomik. Arbënor i mishëronte modelin e aktivistit që veprimin politik nuk e shihte si një akt spontan të izoluar, por si rezultat dhe kulmim të një pune organizative. Veprimi politik për të ishte shpallja publike e ekzistencës së mrekullueshme të një kolektivi politik barazitar që e mundëson veprimin. Kjo e

mbante Arbënorin jo në akte politike të izoluar dhe individuale, por në një lëvizje permanente kolektive. Aktivisti është i tillë vetëm për sa është me të tjerë aktivistë. Kjo bindje e Arbënorit është bindja jonë dhe kjo e mban atë të pandashëm prej nesh dhe kujtimi i tij na mban edhe neve po ashtu", është thënë në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.



# Lëvizja Vetëvendosje dorëzoi nismën ligjore për peticione



PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka dorëzuar të enjten në Kuvendin e Kosovës nismën ligjore për peticione. "Vullneti kolektiv dhe kërkesat e qytetarëve të shprehura përmes peticionit janë një e drejtë politike dhe kushtetuese që i japin kuptim demokracisë dhe e mbrojnë atë nga shpërdoruesit dhe mohuesit e saj. Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është element esencial për demokracinë kudo dhe sidomos në Kosovë. Projektligji i proceduar nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje përcakton ligjërisht për herë të parë në

Kosovë rolin dhe rëndësinë e peticioneve, mënyrën, përmbajtjen dhe efektet e tyre", është bërë me dije në njoftimin e LV-së. Sipas kësaj partie, një ligj i tillë i ka munguar Kosovës kaherë. "Në një kohë kur vullneti i shprehur edhe përmes zgjedhjeve zhvleftësohet, kur demokracia përkeqësohet, kur hendeku midis institucioneve dhe qytetarëve thellohet, bëhet edhe më i domosdoshëm krijimi i mundësive ligjore për qytetarët që ta shprehin vullnetin e tyre dhe që të bëhen pjesë e marrjes së vendimeve në jetën politike e institucionale", theksohet në njoftimin e LV-së.

# 30 pacientë me koronavirus të shtrirë në QKUK

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës po trajtohen 31 pacientë të infektuar nga koronavirusi. Infektologu Valbon Krasniqi ka thënë për "Radion

Evropa e Lirë" se gjendja e tyre është stabile. Sipas tij, shtatë pacientë janë duke u trajtuar me oksigjenoterapi, tre pacientë janë në repart intensiv, në gjendje të rëndë, kurse njëri prej tyre është në gjendje më kritike.

Në Kosovë deri tash janë konfirmuar gjithsej 1 298 raste me koronavirus. Prej këtyre, 31 pacientë kanë humbur jetën. Numri i përgjithshëm i të shëruarve nga koronavirusi ka arritur në 913.





# IKShPK-ja pranon 15 000 teste për Covid-19

15 000 kite për teste për Covid-19 janë dhënë donacioni nga Ecolog, Eurokoha dhe AWR Abbruch. Prej këtyre, 12 000 janë për Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK-në), 2 000 për Maqedoninë dhe 1 000 për Preshevën

qendrës gjatë kohës së pandemisë. Ministri Zemaj ka falënderuar profesionistët e IKShPK-së për punën e bërë sikurse edhe profesionistët e shërbimeve të tjera shëndetësore, të cilët në këtë kohë mundësuan që Kosova të qëndrojë mirë sa i përket menaxhimit të Covid-19. "Sot kam kënaqësinë që e pranojmë një donacion të nevojshëm për qytetarët e Kosovës dhe përgjatë kësaj kohe, falënderimi shkon për heronjtë

dhe profesionistët për punën në luftimin e pandemisë", u shpreh ministri Zemaj.

Ambasadori Heldt ka pohuar se donacioni i sotëm është një kontribut i diasporës në Gjermani. Ai i ka përgëzuar institucionet, punonjësit shëndetësorë në Kosovë dhe qytetarët për bashkëpunimin në parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Lasim Destani, Remzi Ejupi e Nazim Viqa thanë se janë të lumtur që mund të ndihmojnë

me kontributin e tyre dhe të diasporës dhe theksuan se iniciativa e tyre ishte ndërmarrë që në fillim të pandemisë, porse kërkesat në tregun ndërkombëtar ishin shumë të mëdha për të siguruar materiale për testim. Edhe nga kjo ngjarje iu bë thirrje popullatës që t'i zbatojmë masat e qeverisë dhe rekomandimet e IKShPK-së për bartje të maskave, ruajtje të distancës fizike dhe mirëmbajtje të higjienës individuale dhe kolektive.

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 11 QERSHOR** - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë të enjten se kontributi i donatorëve është përkrahje e madhe për luftimin e pandemisë Covid-19, ndërsa ka falënderuar profesionistët shëndetësorë për kontributin e tyre në luftën kundër sfidës të shëndetit publik në Kosovë. Ai ka thënë kështu në një aktivitet të mbajtur në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, ku tre afaristë shqiptarë që veprojnë në Gjermani, Lazim Destani (Ecolog), Remzi Ejupi (Eurokoha) dhe Nazim Viqa (AWR Abbruch) i dorëzuan IKShPK-së një donacion me 15 mijë kite për teste të Covid-19 (innuPREP Virus TS RNA kit), të cilat do ta ndihmojnë procesin e testeve kundër virusit Korona në Kosovë. Prej këtyre kiteve për teste, 12 000 do të jenë për Kosovën, 2 000 për Maqedoninë dhe 1 000 për Preshevën.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt. Para pranimit zyrtar të donacionit,

ata vizituan Qendrën për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse në IKShPK, ku nga drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, u njoftuan për aktivitetin e



## Këshilli i Investitorëve Evropianë: Ekonomia digjitale mund ta ndihmojë rimëkëmbjen ekonomike

**EPOKA E RE** A. MAVRAJ

**PRISHTINË, 11 QERSHOR** - Këshilli i Investitorëve Evropianë (EIC) ka mbajtur të enjten tryezën virtuale të diskutimit në vazhdimësi të konsultimeve me aktorët kryesorë, bizneset, ndërmarrësit dhe të vetëpunësuarit në sektorin ekonomik në vend.

Temë diskutimi në këtë tryezë ishin masat të cilat autoritetet e Qeverisë së Kosovës mund t'i miratojnë në kuadër të pakos për



rimëkëmbje ekonomike. "Ne jemi duke punuar me anëtarët tanë, Zyrën e BE-së në Kosovë,

Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe ekspertë nga kompanitë anëtare të EIC për t'u

përgjigjur pyetjes: Cila është masa e duhur për të krijuar një klimë favorizuese të të bërit biznes dhe të tërheqjes së investimeve në kohë pas pandemisë Covid-19?" - janë shprehur përfaqësues të EIC-së. Në komunikatën e Këshillit të Investitorëve Evropian theksohet se rekomandimet e dala nga tryeza virtuale e diskutimit do të përfshihen në dokumentin e politikave i cili do t'i dorëzohet qeverisë në ditët në vijim. Sipas kësaj komunikate, pos të tjerash, EIC konsideron se e ardhmja e

digjitalizimit të operimit të bizneseve dhe investimet e huaja direkte në këtë sektor do ta ndihmojnë vendin të rimëkëmbet pas fazës së pandemisë dhe do ta rrisë konkurrueshmërinë e bizneseve të Kosovës. "Korniza e rekomandimeve do t'i përkufizojë tre fusha kryesore: aktivitetet digjitale ekonomike, adoptimin digjital dhe infrastrukturën ligjore dhe praktike të investimeve digjitale në Kosovë", thuhet në këtë komunikatë.

## BE-ja mbështet Kosovën për përmirësimin në fushën e arsimit

**PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER)** - Ministri i Arsimit, Ramë Likaj, ka zhvilluar të enjten takim virtual me shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova. Duke pasur parasysh situatën me pan-

deminë Covid-19, me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, takimi i parë mes tyre është zhvilluar në distancë.

Ambasadorja Apostolova e uroi ministrin Likaj për detyrën e re dhe tha se

Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar që ta mbështesë Kosovën për përmirësimin e mëtejshëm në fushën e arsimit. Ndërkaq ministri Likaj e falënderoi ambasadorën Apostolova për ndihmën dhe

përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë Bashkimi Evropian për Kosovën dhe për arsimin në veçanti, ndërsa theksoi nevojën e mbështetjes së mëtutjeshme në realizimin e programit qeveritar për arsim.





# Kosova euroatlantike meriton unitet ndërmjetësimi BE-ShBA



**Prof. Lisen BASHKURTI**

Në fazën aktuale procesi i zgjidhjes së krizës Kosovë - Serbi ka hyrë në një fazë kritike. Pas një bllokimi disavjeçarë për arsye lokale, rajonale dhe konjunktive ndërkombëtare, duket se po vjen momenti që aktorët dhe faktorët relevantë t'u rikthehen bisedimeve. Qëllimi i bisedimeve në këtë fazë është arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse përfundimtare për njohje reciproke në kufijtë ekzistues, e ratifikuar nga parlamentet e dy shteteve si dhe me vlefshmëri juridike dhe garanci ndërkombëtare.

Në këtë fazë, krahas procedurës për hapjen e negociatave dhe të përgatitjes së thelbit përmbajtësor të draft-marrëveshjes janë edhe dy aspekte që mbeten objekt debati dhe polemike politike në Kosovë dhe më gjerë: së pari, formati i ndërmjetësimit ndërkombëtar dhe, së dyti, shpejtësia e negociatave për arritjen e marrëveshjes. Në këtë shkrim do ta analizojmë aspektin e parë, atë të ndërmjetësimit ndërkombëtar. Aspektin e dytë do ta vijojmë së afërmi me një shkrim tjetër.

Bisedimet, dialogu dhe negociatat Kosovë - Serbi vuajnë nga mungesa e thellë e besimit midis palëve si dhe nga garancia e zbatimit të vendimeve të dala prej tyre. Për këto arsye, pra besueshmëri dhe garancie për zbatimin e vendimeve, negociatat Kosovë - Serbi kanë nevojë për ndërmjetësim diplomatik ndërkombëtar, me kredibilitet dhe fuqi imponuese e garantuese mbi palët.

Lidhur me ndërmjetësimin ndërkombëtar brenda Kosovës kohët e fundit po ndodh një përplasje serioze. Po duken qartë se polemika politike dhe polarizimi në Kosovë edhe lidhur me formatin e ndërmjetësimit ndërkombëtar po thellohet. Debati po bëhet rreth tri pyetjeve: Do të vijojë të mbetet ndërmjetësuese e vetme BE-ja? Do të hyjë si

ndërmjetësuese e vetme ShBA-ja? Apo do të kemi një rikthim te ndërmjetësimi dypalësh euro-atlantik, BE - ShBA? Ky debat vë në dyshim serioz vetë natyrën e projektit euro-atlantik të Kosovës.

Le të kujtojmë se prej Konferencës së Rambujesë, më 1999, faktori politik në Kosovë ka qenë i unifikuar në qëndrimin pro euro-atlantik. Ishte ky unifikim i brendshëm kosovar që ia lehtësoi punët faktorit euro-atlantik gjatë dizajnit, mbështetjes dhe realizimit të projektit të Kosovës. Euro-atlantizmi ka qenë përcaktues për çlirimin e Kosovës nga diktatura serbe për shpalljen e pavarësisë së saj, për shtetformimin, për njohjen ndërkombëtare dhe më tej për integrimin në nisma dhe organizata rajonale dhe universale.

Për herë të parë projekti i Kosovës u devijua njëanshmërisht nga bashkëveprimi euro-atlantik BE-ShBA në vitin 2012. Ishte koha kur Shtëpia e Bardhë, nën presidentin Obama, deklaroi një strategji tërheqje nga Ballkani dhe Lindja e Mesme drejt Lindjes së Largët. Për të mos lënë boshllëk politikodiplomatik BE rriti interesimin, praninë dhe veprimin e tij në Ballkan. Problem themelor ngelej, sikundër edhe sot, zgjidhja e nyjës Kosovë - Serbi. Për këtë BE-ja shprehu gatishmërinë për t'i ndërmjetësuar bisedimet Kosovë - Serbi pa praninë e ShBA-së.

Pikërisht në vitin 2012 Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë në bazë të së cilës mandatonte Qeverinë e Kosovës për t'i hapur bisedimet teknike me Serbinë, që për herë të parë do të bëheshin përmes ndërmjetësimit të BE-së. Ishte kjo iniciativa e parë e ndërmarrë nga Kosova për t'u pajtuar për ta ndryshuar formatin euro-atlantik të ndërmjetësimit ndërkombëtar të bisedimeve Kosovë - Serbi nga formati i ndërmjetësimit dypalësh euro-atlantik BE-ShBA, në ndërmjetësues të njëanshëm vetëm BE pa ShBA. Pra, ishte Qeveria e Kosovës, e kryesuar asokohe nga Thaçi që e mbështeti, pa e vuar mendjen në mënyrë afatgjatë këtë ndryshim të formatit të ndërmjetësimit ndërkombëtar, nga format euro-atlantik BE-ShBA, në format të njëanshëm

BE, pa ShBA.

Palës serbe i konvenonte shumë mënjanimi i ShBA-së nga ndërmjetësimi i bisedimeve Kosovë-Serbi, prandaj u pajtua menjëherë me ndryshimin e formatit të ndërmjetësimit sepse pala serbe nga njëra anë ishte e interesuar për ta përçarë dyshen BE-ShBA në qasjen ndaj Kosovës, nga ana tjetër, duke mos pasur praninë e faktorit të ShBA-së, pala serbe do ta shfrytëzonte më lehtë përçarjen ekzistuese brenda BE-së lidhur me statusin e Kosovës për realizimin e strategjisë së saj politike në marrëveshjen e ndërmjetësuar vetëm nga BE-ja. Në këtë lëvizje, Serbia gëzonte mbështetjen e plotë të Rusisë sepse i shërbente njëkohësisht kësaj të fundit edhe si 'Kalë Troje' për interesat gjeopolitike të saj për ta dobësuar aleancën Euro-Atlantike në tërësi dhe BE-n në veçanti.

Bisedimet Serbi - Kosovë, me ndërmjetësimin e BE-së, pa praninë e ShBA-së, vijuan plot tetë vjet. Ato prodhuan rreth njëzet e pesë marrëveshje teknike dhe politike, shumica e të cilave nuk janë zbatuar. Mbas tetë vjetësh bisedimet u bllokuan. Diplomacia e BE-së, asokohe me Federika Mogerinin në krye, nuk i udhëhoqi dot bisedimet drejt zgjidhjes përfundimtare. Kryediplomatja e BE-së me apo pa dashje hapi çështjen më të rrezikshme për Kosovën, Ballkanin dhe mbarë Evropën - atë të ndryshimeve territoriale. Mogerini ra në grackën e opsonit serb, të mbështetur nga presidenti i Kosovës, H. Thaçi, e më pas edhe nga kryeministri i Shqipërisë, E. Rama. Treshja Vuçiq-Thaçi-Rama rreth vitit 2016 filloi të veprojë në mbështetje të projektit serb dhe nën ndikimin e faktorëve të tjerë gjeopolitik dhe lobues në mbështetje të tij. I gjendur përballë sfidave të tjera të brendshme asokohe, BE-ja dhe shtetet kryesore të tij nuk ua kushtuan vëmendjen e duhur bisedimeve Kosovë - Serbi, derisa kriza e tyre shpërtheu hapur politikisht e publikisht në Kosovë, Shqipëri, Ballkan dhe në botë.

Kur situata u fut në një tunel të mbyllur dhe të rrezikshëm, të dy partnerët euro-atlantikë, BE-ja dhe ShBA-ja, iu rikthyen agjendës së Ballkanit, me fokus të veçantë bisedimet Kosovë-

Serbi. Për, këtë herë, dy partnerët euro-atlantikë, BE-ja dhe ShBA-ja, nuk duken të jenë të unifikuar politikisht dhe të pajtuar diplomatikisht për të ndërmjetësuar së bashku, si më parë, për arritjen e marrëveshjes përfundimtare gjithëpërfshirëse Kosovë - Serbi. Klima e marrëdhënieve BE-ShBA në përgjithësi nuk është si më parë, sikundër qasja e tyre ndaj zgjidhjes së krizës Kosovë - Serbi nuk është e qartë. Edhe në Kosovë është reflektuar dilema ShBA - BE.

Një qasje politike kosovare është për ndërmjetësim vetëm nga ShBA-ja dhe jo më BE-ja. Paradoksalisht, këtë opsjon e mbështet presidenti Thaçi dhe përkrahësit e tij. Themi paradoksalisht sepse Thaçi ka ndërruar tri herë qasjen e tij ndaj ndërmjetësimit ndërkombëtar. Në fillimet e çështjes së Kosovës që nga Rambujeja e vitit 1999 deri në vitin 2011, Thaçi ka mbështetur dyshen euro-atlantike BE-ShBA si ndërmjetësues ndërkombëtarë për Kosovën. Nga viti 2012 deri në 2018-n ishte sërish Thaçi që u pajtua me ndërmjetësimin e njëanshëm të BE-së, pa ShBA-në, format ky anti-ShBA i preferuar i Serbisë. Mbas vitit 2018, kur opsioni sekret serbo-rus për copëtimin territorial të Kosovës u ekspozua dhe u kundërshtua masivisht në Kosovë, Ballkan dhe në Evropë, por ngeli ambig në Shtëpinë e Bardhë, është sërish Thaçi që radikalizon qëndrimin e tij, duke bërë një kthesë në mbështetje të ndërmjetësimit vetëm të ShBA-së dhe duke u deklaruar si anti-BE-së.

Lëvizje të tilla të paprincipita dhe të pajustificueshme të presidentit Thaçi ndaj qasjes së faktorëve euro-atlantikë, BE-ShBA, duket se kanë një prapavijë të fshehtë. Së pari, ato janë lëvizje të nxitura nga projekti i bisedimeve sekrete Kosovë - Serbi, i cili qartësisht synon copëtimin e Kosovës dhe të ekonomisë së saj në dobi të Serbisë. Së dyti, lëvizjet e Thaçit ndaj qasjes euro-atlantike BE-ShBA lidhen edhe me interesa personale politike të tij në Kosovë. Së treti, lëvizjet e Thaçit pa dyshim diktohen edhe nga problematikat që ai ka me drejtësinë ndërkombëtare për periudhën përpara, gjatë dhe pas luftës për çlirimin e Kosovës. Në analizë të fundit çdo qasje nga kushdo që të vijë

që synon përçarjen euro-atlantike në përgjithësi dhe për Kosovën në veçanti është drejtpërdrejt dhe pa pikë dyshimi në dobi të faktorëve serbo-rus.

Opsioni i dytë, që duket i mbështetur më gjerësisht në Kosovë, është ndërmjetësimi unik euro-atlantik, ShBA-BE. Në Kosovë nuk ka qasje me ndikim të madh anti-ShBA. Shfaqjet aty-këtu të simptomave kundër ShBA-së janë sporadike dhe të paqëndrueshme dhe lidhen më shumë me konjunkturën politike afatshkurtër dhe me pakënaqësitë ndaj individëve të veçantë përfaqësues të ShBA-së dhe assesi nuk lidhen me shtetin dhe popullin amerikan. Në Kosovë, gjithashtu, nuk ka frymë anti-BE. Simptomat që shfaqen janë gjithashtu sporadike dhe të paqëndrueshme dhe lidhen me konjunkturë afatshkurtra dhe ndonjë shtet të veçantë jo miqësor me Kosovën. Faktorët lokalë në Kosovë janë gjerësisht euro-atlantikë. Ato e konsiderojnë dhe mbështesin BE-në dhe ShBA-në si shpëtimtarët dhe mbështetësitë e tyre më të mëdhenj. Mbi këtë bazë të gjerë popullore pro euro-atlantike politika në Kosovë duhet t'i qëndrojë kërkesës për bashkëpunim unik euro-atlantik BE-ShBA deri në fund të projektit të Kosovës dhe kurrësi të mbajnë qasje të dyzuar midis tyre.

Historia 21-vjeçare e Kosovës dëshmon se sa herë faktori euro-atlantik ka vepruar i unifikuar në Kosovë, sukseset e kësaj të fundit kanë qenë të dukshme dhe të garantuara. Kur faktorët euro-atlantikë, për shkaqe të ndryshme, kanë vepruar veç e veç, projekti i Kosovës ka njohur status quo ose kthim prapa. Në qasjen ndaj ndërmjetësimit gjithë faktorit politik dhe institucional në Kosovë nevojitet ta mbështesin formatin e unifikuar euro-atlantik BE-ShBA. Kjo qasje buron nga vetë karakteri euro-atlantik i projektit të Kosovës. Është Serbia dhe mbështetësja e saj e fortë, Rusia, që tentojnë prej vitesh të fusin pyka përçarëse midis faktorit unik ShBA-BE dhe projektit euro-atlantik Kosovë me qëllimin e vetëm për t'i hapur rrugë ndikimit, pranisë, interesave dhe veprimeve gjeopolitike ruse në Ballkan.



# Gjykatat kanë kapacitetet e duhura për t'i trajtuar çështjet e falimentimit

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), në bashkëpunim me programin e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) për Zgjidhje të Borxhit në Ballkanin Perëndimor, kanë mbajtur punëtorinë me temën "Ndikimi i pandemisë Covid-19 në biznese dhe legjislacioni kosovar për ristrukturim dhe falimentim të kompanive".

Në këtë punëtori u konstatua se pandemia Covid-19, përveç ndikimit në shëndetin publik, ka shkaktuar edhe krizë serioze ekonomike të ndërmarrjet e të gjithë sektorëve si rrjedhojë e çrregullimeve në kërkesë dhe furnizim. Po ashtu, u tha se gjatë kësaj kohe një numër i madh i kompanive kanë shprehur pasiguri në mbijetesën e tyre pas pandemisë, ndërsa duke konsideruar ndikimin e masave kufizuese, përdorimi i procedurës së insolvencës mund të jetë shumë i dobishëm për bizneset kosovare të cilat përballen me vështirësi të kësaj natyre.

Syzana Dautaj, koordinatorë e Projektit të IFC për Zgjidhje të Borxhit në Kosovë, duke iu referuar një ankete nga pesë organizata të biznesit, në mesin e të cilave edhe Oda Amerikane mbi ndikimin e pandemisë në ndërmarrjet e Kosovës, tha se 64 për qind të bizneseve në vend shprehin pasiguri për të ardhmen e tyre. Sipas saj, korniza ligjore që rregullon çështjet e insolvencës në këtë kohë është më aktuale se

asnjëherë më parë dhe mund të pritet që një numër i konsiderueshëm i bizneseve në Kosovë ta përdorin procedurën për zgjidhjen e borxhit dhe ristrukturimin.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, theksoi se Ligji i Falimentimit i qershorit të vitit 2016 përfshin standardet më të mira evropiane dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës duke zëvendësuar edhe një kornizë paraprake ligjore e cila ishte gati e pazbatueshme.

Zeka ka deklaruar se si pasojë e situatës së krijuar pas shpërthimit të pandemisë, mund të ballafaqohemi me numër më të madh të ndërmarrjeve insolvente që rrezikojnë falimentimin dhe, rrjedhimisht, me numër më të madh të debitorëve që mund t'u nënshtrohen procedurave të riorganizimit ose ristrukturimit të borxheve, prandaj në rrethana të tilla jemi me fat që kemi një ligj i cili rregullon këto çështje.

Mahir Tutuli, gjyqtar në Departamentin për Çështje Ekonomike në Gjykatën e Apelit, tha se Ligji i falimentimit që ka hyrë në fuqi në vitin 2016 është ligj gjithëpërfshirës i cili u mundëson bizneseve riorganizim të veprimtarive të tyre përmes gjykatave e, megjithatë, deri më tani në Kosovë ka pak raste të tilla. Sipas tij, shumë faktorë ndikojnë në numrin e vogël të këtyre rasteve, e ndër to është edhe stigmatizimi i fjalës falimentim, e cila perceptohet shumë negativisht.

Tutuli theksoi se të paktë janë ata



që kuptojnë se falimentimi përbën vetëm një procedurë përmes së cilës synohet të arrihet riorganizimi i ndërmarrjeve, respektivisht rimëkëmbja ekonomike e tyre, ndërsa nëse as kjo nuk mund të arrihet, atëherë bëhet likuidimi i ndërmarrjes. Sipas gjyqtarit, përparësitë e kësaj procedure janë garantimi i një sigurie për kreditorët që kanë kërkesa ndaj ndërmarrjes që i nënshtrohen falimentimit, krijimi i hapësirës për bizneset që të lehtësohen në një periudhë të caktuar pas moratoriumit që ndalon të gjitha kërkesat drejtuar tyre dhe mundësia për planifikim të riorganizimit.

Gjyqtari përmendi se faktorë të tjerë për mospërdorim të kësaj procedure janë edhe hezitimi i juristëve për t'u marrë me këtë fushë dhe dispozita ligjore e cila kërkon që për hapjen e një rasti të falimentimit të jenë domosdoshmërisht dy

kreditorë. Më tutje, ai foli edhe mbi dispozitat e ligjit të ri të falimentimit.

Ardi Shita, ekspert Ligjor në Programin e IFC për Zgjidhje të Borxhit, tha se pandemia Covid-19 mund të sjellë rritje të rasteve të falimentimit të ndërmarrjeve, por ligji i ri ka qëllim primar ruajtjen e vendeve të punës dhe riorganizimin e bizneseve për ta evituar likuidimin e plotë të tyre. Ai ka theksuar se ky ligj, gjithashtu, ofron ruajtjen e vlerës së asetëve, ku palët mund të kërkojnë që pronat joesenciale të biznesit të largohen nga lista e pasurive falimentuese gjatë procesit të falimentimit, në mënyrë që të ruhet vlera e tyre. "Ky ligj në moratoriumin e tij ka përparësi ndalimin e veprimeve ndaj ndërmarrjes ashtu që kreditori nuk mund të kërkojë përmbushje të detyruar të obligimeve të parapara në

kontratë nga debitori gjatë kohës sa lënda është në proces, duke krijuar në këtë mënyrë lehtësira për rishqyrtim të planit për riorganizimin e biznesit", ka deklaruar Shita.

Ai, gjithashtu, përmendi se ky ligj mbron të drejtat e të gjitha palëve të përfshira në procesin e falimentimit, gjersa shtoi se i njëjti parasheh edhe konceptin e lirimit nga borxhet i cili i jep të drejtë debitorit të kërkojë nga gjykata lirim nga borxhet në përfundim të procesit të falimentimit, që do të thotë se të gjitha aspektet e trajtuara në këtë proces nuk mund të kërkojnë përsëri nga asnjëra palë. Ai ka theksuar se kapacitetet e gjykatave të Kosovës janë më se të mjaftueshme dhe të avancuara në krahasim me rajonin por, megjithatë, vetëdija ndaj procesit të falimentimit duhet të rritet, thuhet në komunikatën e dërguar për media.

## Kuvendi miraton propozimin e qeverisë për tejkalim të deficitit buxhetor

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë përkrahur propozimin e qeverisë për tejkalimin e deficitit buxhetor, i cili është propozuar nga ministria e Financave, Hykmete Bajrami. Ky propozim ka marrë 59 vota për, 41 kundër dhe një abstenim. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe nga ata të PDK-së, me arsyetimin se qeveria nuk ka treguar në mënyrë të hollësishme se ku do t'i shpenzojë ato mjete që është duke i kërkuar. Por, deputetët e LDK-së, AAK-së dhe Nismës e kanë përkrahur një kërkesë të tillë, pasi kanë thënë se kjo do të lejojë që qytetarëve që kanë pësuar nga pandemia t'u ndihmohet përmes Pakos Emergjente Fiskale dhe asaj për Rimëkëmbje Ekonomike. Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka thënë se pandemia

Covid-19 ka ndikuar negativisht në ekonominë e vendit. Sipas saj, nëse kjo situatë vazhdon, mund të ketë pasojë edhe në muajt e ardhshëm. "Situata e pandemisë Covid-19 ka ndikuar negativisht dhe pritet që edhe në muajt në vijim kjo gjendje e rëndë të vazhdojë. Rritja që ishte menduar të jetë plus 4 për qind, tani mund të jetë deri në minus 5 për qind", ka deklaruar Bajrami.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputet i LV-së, Hekuran Murati, ka deklaruar se kjo kërkesë nuk është e arsyetuar, duke ftuar që të mos votohet ky propozim. Edhe Partia Demokratike e Kosovës ka bërë me dije se nuk do ta përkrahë propozim-vendimin e qeverisë Hoti për ndryshim dhe tejkalimin e deficitit buxhetor. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Bedri Hamza, duke arsyetuar mospërkrahjen e këtij vendimi, tha se nuk do të bëhen pjesë e shkeljeve ligjore.





## Sabri Fejzullahu nderohet me çmimin 'Çelësi i Qytetit' nga Komuna e Prishtinës



PRISHTINË, 11 QERSHOR (ER) - Këngëtarit Sabri Fejzullahu të enjten i është dhënë "Çelësi i Qytetit" nga Komuna e Prishtinës. Në Ditën e Çlirimit të Prishtinës i pari i kryeqytetit, Shpend Ahmeti, ka thënë se kjo mirënjohje po i ndahet për kontributin e dhënë për karrierën e gjatë të këngëtarit të njohur. "Kemi vendosur që 'Çelësin' t'ua japim juve për kontributin e dhënë për Prishtinën. Po them për Prishtinën për shkak se edhe atë ditë kur e mbajtëm koncertin njerëzit të identifikojnë si prishtinas. Unë të kam quajtur zemra e Prishtinës dhe të faleminderit për 55 vjet karriere. Edhe gjatë kësaj karriere këngët më të njohura i ki për Prishtinën. Edhe atë ditë besoj na ke kënaqur edhe me kon-

cert", ka thënë ai.

Kujtimi më i mirë i periudhës së pandemisë, Ahmeti, ka thënë se do të mbetet koncerti i Sabri Fejzullahut i mbajtur në stadiumin "Fadil Vokrri".

E Sabri Fejzullahu ka thënë se ndihet i nderuar që i është ndarë "Çelësi i Qytetit". "Shpend, më ke nderuar shumë si kryetar dhe gjithë asambleja juaj që punon edhe që ka punuar më së miri që katër muajt e fundit. Unë si qytetar, si çdo njeri i përcjell punët e kryetarëve të komunave. Jam në kontakt me njerëz, edhe me pastrues, edhe me bujq, edhe me fëmijë. Flitet që në Ballkan, po e them me gjithë zemër, jeni njeriu dhe komuna më e suksesshme", ka theksuar Fejzullahu.

## Komuna e Kamenicës, pjesë e projektit 'Së bashku kundër abuzimit të fëmijës'

KAMENICË, 11 QERSHOR (ER) - Komuna e Kamenicës, së bashku me "Qendrën për Arsim të Kosovës-KEC", të enjten kanë mbajtur një takim, në të cilin kanë diskutuar për projektin "Së bashku kundër abuzimit të fëmijës", projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me u. D. drejtoreshën e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Mirhane Morina-Bislimi dhe zyr-

tarë të tjerë të sektorit të arsimit dhe të Qendrës për Punë Sociale kanë pritur në takim Ardita Kabashin, menaxhere e këtij projekti dhe ekspertin për hartimin e planeve të veprimit për këtë projekt.

Kryetari Kastrati, duke falënderuar organizatën "Qendra për Arsim të Kosovës - KEC", për bashkëpunim në këtë projekt të rëndësishëm për nxënësit e Kamenicës, ka thënë se si institucion do ta adresojnë këtë



fenomen që ka pasoja në të gjitha anët. "I lumtur që Kamenica është pjesë e projektit 'Së bashku

kundër abuzimit të fëmijës' nga organizata KEC. Fatkeqësisht, dhuna ndaj fëmijëve si fenomen

është akoma mes tabusë e heshtjes dhe si shoqëri e institucion duhet ta adresojmë këtë problem që ka pasoja në të gjitha anët. Si komunë e kemi dëshmuar që angazhimi ynë për një jetë më të mirë është për të gjithë, pa dallim. Fokusi e prioriteti ynë është fëmijëria e hershme sepse nuk mund ta paramendojmë një shoqëri të shëndoshë nëse dhuna psikologjike, fizike, apo sociale është duke rënduar mbi supet e më të dashurve tanë", ka thënë ai.

## Identifikohen deponitë ilegale në Komunën e Drenasit

DRENAS, 11 QERSHOR (ER) - Komuna e Drenasit, respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë në kuadër të planifikimeve të saj është duke vazhduar me intensitet aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtje të mjedisit. Në këtë drejtim, për pesë ditë me radhë janë ndërmarrë veprime aktive në terren të cilat kanë pasur për qëllim hulumtimin për identifikimin e deponive ilegale në

Komunën e Drenasit. "Vlerësimin e realizuan Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në bashkëpunim me GIZ-in dhe me zyrtarin komunal për menaxhimin e mbeturinave dhe inspektorin mjedisor komunal. Gjatë këtij procesi u shfrytëzuan të dhënat në bazë të raportit të vitit 2019 dhe u vizituan të gjitha rrugët. Komuna e Drenasit për çdo vit

është duke u kujdesur që t'i largojë deponitë të cilat, fatkeqësisht, për çdo vit po rikrijohen. Deri më tani janë larguar 54 deponi ilegale. Me këtë rast Komuna e Drenasit dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë u bëjnë thirrje të gjithë qytetarëve që ta ruajnë mjedisin dhe shëndetin publik si dhe të ndihmojnë në parandalimin e deponive ilegale", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



## Në Gjilan shpërndahen 16 tonë koncentrat për gjedhe

GJILAN, 11 QERSHOR (ER) - Organizata për Zhvillim Rural "Mëshqerra", me seli në Prishtinë, ka mbështetur të enjten përfutuesit e projektit të lopëve qumështore të racës Hollshajt me koncentrat 18 për qind proteina në Komunën e Gjilanit.

Nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka falënderuar organizatën si donatore e këtij projekti dhe ka konfirmuar se qeverisja komunale është në shërbim të plotë dhe mbështetjet

maksimale për implementimin e këtij projekti. "Komuna e Gjilanit është falënderuese për këtë donacion në sektorin e bujqësisë dhe me këtë trend do të vazhdojmë edhe më tutje që participimin që e bëjnë fermerët, ta mbështesim në mënyrë direkte. Fermerët janë shtylla e zhvillimit të blegtorisë si degë dhe e fushës së bujqësisë në përgjithësi, prandaj me mbështetjen e donatorëve dhe prioritetet e komunës do të bëjmë që zhvillimi lokal



ekonomik të shënojë rritje, sepse regjioni ynë është i njohur me tokën bujqësore si mundësi të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik", ka thënë Ismajli. Florentina Kida-Gërguri nga organizata "Mëshqerra" ka

thënë se ky projekt ka qëllim zhvillimin e sektorit të blegtorisë dhe në kuadër të kësaj sot, me participimin e përbashkët të fermerëve, po shpërndahen 16 tonë koncentrat në fazën e parë për fermerët që janë përfutues të lopëve Hollshajt prej organizatës. Ajo ka konfirmuar se projekti do të përcillet edhe në terren me vizita të rregullta dhe ofrim të shërbimeve të ndryshme në mënyrë që kjo racë e lopëve qumështore të jetë gjithnjë e më shumë në këtë regjion.

Ndërsa drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, ka thënë se janë 66 ekonomi familjare që kanë mundësinë e rritjes dhe zgjerimit të kapaciteteve të tyre blegtoriale dhe përmirësimit racor falë donacionit që ka ardhur nga organizata "Mëshqerra". Fermerët, edhe profesionistët e fushës, vlerësojnë se sasia e planifikuar e koncentratit rrit performancat prodhuese të qumështit dhe riprodhimin e mëtutjeshëm të lopët në shumëzimin e parë të tyre.



Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (4)

# PREKAZI DHE ADEMI



**Bedri ISLAMI**

A do të ndodhnin zhbërja dhe harresa? Ata ishin të bindur se po. Nuk do të ishte hera e parë që do të ishte hera e fundit. Nuk do të kishin kohë për gabime të tjera sepse kishte filluar rrokullima e pandalshme dhe theqafja e tyre. Njerëzit e rrethuar në mëngjesin e bardhë të 5 marsit të vitit 1998, tashmë kishin bërë edhe ata rrethimin e tyre. Askush më mirë e më shumë se ata, nuk e kishin ngritur shpirtin e madh të revoltës. Megjithatë, ajo që kishte ndodhur deri më 4 mars do të ishte vetëm një pjesë e jetës së tyre të furishme, do të ishte e pazakontë, por gjithsesi jo e plotë. Do të kishin tri ditë netët e luftës dhe pastaj do të vinte koha e tyre...

Rreth orës 5:00 të mëngjesit rrethimi ishte bërë i plotë. Ishin zënë thujse të gjitha shtigjet, mbi 200 mjete të blinduara kishin rrethuar vendlindjen e tyre, Prekazit, 15 gryka topash ishin të gatshëm për të granatuar, njëkohësisht ishte rrethuar krejtësisht lagjia tjetër përbri, ajo e Lushtakëve, Llausha dhe Açareva ishin nën rrethim, Vojniku ishte tashmë nën presionin e izolimit, të gjitha rrugët drejt Prekazit ishin përmbyllur nën një rreth të zjarrtë plumbi, predhash e baroti. Do të duhej një hartë e tërë për t'i shtrirë dhembët e kuçedrës. Gjithçka dëshmonte se përgatitja për këtë natë-ditë kishte qenë e gjatë, e jashtëzakonshme e, njëkohësisht, e përbindshme. Telefonat dhe mesazhet serbe nuk pushuan gjithë natën.

Do të kthehemi përsëri në këtë fillim dite të pesë marsit dhe në çastet para saj. Do të kthehemi sepse nuk mund të bëjmë pa to asnjë histori jo vetëm historinë e njerëzve të rrethuar, por as pjesë të historisë së vetvetes të kombit. Sidoqoftë kishte qenë një natë me brymë të bardhë dhe nëpër fillësën e bjeshkëve përreth brymëzat dukeshin tani si yje të bardhë që kishin rënë aty këtu. Më pas do të ndodhte një fenomen i çuditshëm, i pandodhur më parë, brymëzat ose do të shkriheshin nga nxehtësia e armëve, ose do të përskuqeshin nga gjaku i derdhur. Mes dy rrethimeve nuk kishte mbetur asnjë zgjidhje tjetër. Rrethimi i zi serb kishte në vete mijëra forca të çfarëdollojshme dhe idenë e çrënjosjes nga vatrata. Rrethimi i bardhësisë kishte pasur në vete gjithnjë idenë e lirisë dhe sado mund të dukej i brishtë, ai ishte në agun e tij dhe si çdo gjë në ag, do të kishte të ardhmen. Nëse deri atëherë ideja do të ishte e

mbrojtur me vitalitetin e një kombi, tashmë vitaliteti dhe ideja do të kishin edhe simbolet e tyre.

Ishte përmbyllur rrethimi i 4 marsit dhe po hapej dita e pesë marsit. Cilët ishin të rrethuarit? Shumë shpejt gjithçka do të bëhej e njohur për të gjithë. Historia ishte në të mbrojturin e saj, magjia e legjendës po përgatiste mitin e së nesërme.

## Prekazi

Historia ka të vërtetën e saj, legjenda ka edhe ajo të sajën. Jo rrallë e vërteta historike është e ndryshme nga e vërteta legjendare. Jo rrallë ata ndërthuren me njëra tjetrën, deri në atë pikë, sa që është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, të kuptosh fillësën e kufijve të njërës dhe përfundimin e tjetrës. E vërteta legjendare është shpesh herë një mjet për të arritur qëllimin që një komb i vë vetes, në fund të fundit, historia dhe legjenda kanë të njëjtën qëllim, të ndërtojnë nën njeriun e çastit, njeriun e përjetshëm. Mirëpo ajo që po ndodhte në fillësën e ditës së 5 marsit do të ishte diçka krejt tjetër, krejt e pazakontë, është ndër rastet kur historia plotëson legjendën, është ndër rastet kur historia është e përgjithshme dhe legjenda është për hollësitë. E pazakontë, por e vërtetë.

Prekazi e meriton një çudi të tillë. Prekazi në vetvete është një çudi. Në qoftë se duam të kuptojmë Prekazin, le të parafytyrojmë njeriun që është mësuar të jetë i lirë, edhe kur të tjerët rreth tij ndjehen të robëruar, le të parafytyrojmë nga njëra anë pushtuesin serb dhe nga ana tjetër malësorin e Drenicës; dhe përballë këtyre dukurive të pakrahasueshme, që janë një kundërvënje e pafund e agresivitetit ndaj mirësisë, e kërcënimit ndaj butësisë, le të vëmë këtë malësor, përgjithësisht me flokët e gështenjtja, me sy të qartë dhe shikim të kthjelltë, i furishëm, por gjithherë brenda masës që i lejon kodi i tij i nderit, nganjëherë i vrazhdë në dukje, por gjithherë me zemrën e një fëmije; le të vëmë këtë malësor, i cili e ka kufirin e tij mes çatisë mbi kokë dhe qiellit, që jeton brenda gardhit të tij, duke pasur në vëmendjen e pashuar gjithë vendet ku flitet shqip dhe përtej saj, këtë njeri që i falet grurit, qumështit, barit të gjelbër; që respekton gjyshërit e stërgjyshërit, me aq forcë e dinjitet sa përulet edhe para varreve të të parëve, këtë njeri që e bën mendjen të jetojë edhe në varr, por kurrë të mos jetë i palirë; malësorin që i falet së pari parmendës, që nderon djersën e derdhur, që përkulet para gjakut, që mpreh kosën dhe harr grurin; që ndoshta beson e nuk beson në perënditë, por i falet gurit të lartë që vesh themelet e shtëpisë apo që është vendi ku janë mbledhur kuvendet

e burrave që shkuan.

Prekazi duket sikur ka dalë nga legjendat për të bërë histori, ai nuk është një histori për të bërë legjenda. Këtej gjërat kanë rrjedhur ndryshe nga e zakonshmja, mirësitë aty janë të përbashkëta, kjo ka bërë që edhe lufta të jetë e përbashkët. Nëse e ke menduar një malësor të tillë, qoftë edhe në përmasat e tij të përditshme jetësore, atëherë e ke më të lehtë të përqendrohesh në atë që mund të sjellin në mendje dy prej tyre, të cilët janë vetë thelbi i asaj që shkruam më lart, brumi nga i cili është gatuar njeriu që e ka bërë mendjen "të jetojë edhe në varr, por të jetë i lirë".

Nuk mund të gesh shëmbëlltyrë më të përsosur të këtij malësori se sa ajo e Adem Jasharit dhe e vëllait të tij, Hamzës. Nuk mund të sjellësh në mendje një rast tjetër, ku njeriu i veçantë është pasqyrë besnike e fisit të tij, ku gjyshërit dhe stërgjyshërit e treqind viteve jetojnë tek vazhduesit e tyre, njëlloj si të ishin pjesë të ditës së djeshme.

## Ademi

Portreti i Adem Jasharit është ai i shqiptarit tipik malësor të Drenicës. Pamja e jashtme e tij dëshmon pikërisht për figurën e malësorit me shikimin e kthjelltë, të qartë, dhe, krejt natyrshëm, është në ekuilibër të plotë me forcat e tij të brendshme, Shtatin ai nuk ka as tepër të madh, as tepër të vogël, trupin as tepër të rëndë dhe as tepër të brishtë: kudo e kurdoherë një pasqyrë vërtet shembullore e harmonisë njerëzore. Ai është një burrë i pashëm, një njeri burror, një malësor fisnik me tipare të rregullta, vështrimi i tij i përqendruar tregon se kemi të bëjmë me një njeri të vendosur deri në skajin e fundit, fjalët e tij të pakta janë shenjë e qëndrësës dhe dëshmi e njeriut të punëve të mëdha.

Adem Jashari, kujtojnë bashkëlufetarët e tij, e kishte zakon të ngrinte lehtësisht kokën lart, shikimi i tij ishte drejtuar gjithnjë së larti dhe kurrë nuk shikonte përdhe. Si për të gjetur oguret dhe zbuluesat që mund të shfaqeshin

ndër retë e qiellit. Mund të thuhet se ishte një njeri i pasur, në se do të llogarisim tokën që kishte familja e tij, pyjet përbri dhe livadhet, ujërat dhe gjënë e gjallë, mjetet dhe gjithë atë që mund të quhej pasuria e tyre. Kjo gjendje mund ta shtynte drejt të zakonshmes, të përditshmes, duke hequr dorë nga ajo që do të vinte. Mirëpo, ai nuk kishte lindur për një fat të tillë, të thjeshtë, të zakonshëm dhe herë pas here, edhe të errët.

Ndonjëherë imaginata njerëzore zgjedh një figurë, ose disa figura të së shkuarës, për të përligjur dëshirat e saj. Ademi thërrret në ndihmë të tij figura madhore të së shkuarës, nuk ka rëndësi se në cilin cep të Shqipërisë ka jetuar figura që thërrret, atij i duhet kjo për të kapërcyer veten dhe për të mos mbetur thjeshtë një prekazali ose një drenicas i zakonshëm. Në më shumë se 15 vite pjesë e strukturave ilegale të lëvizjeve çlirimtare, ai kërkoi të sillte një kohë, që për shumikënd tashmë kishte shkuar. Me gjithë forcën e tij ai vuri përpara syve të mendjes një numër të madh figurash mitike shqiptare, të cilat u rrok t'i trupëzonte gjatë jetës së tij. Përpjekja e tij nuk qe as e para dhe as e fundit, por kurrë më parë, e as më pas, nuk ishte bërë e nuk do të bëhej, me kaq zell, përkushtim dhe madhësi.

Këtë e kanë vërejtur edhe nipërit e bijtë e tij. Tregon nipi i tij, Murati: "Thonë se shpirtat rilindin... shikojeni filmin e Çerçiz Topullit, ngjarjet dhe figurat që kanë lëvizur në atë film dhe në pozicione të ngjashme është gjetur Adem Jashari me shokë gjatë luftës. E njëjta ngjarje ka ndodhur, e njëjta luftë. Çerçizi ka pasur pak fjalë. Edhe Ademi ka folur shumë pak. Anën diplomatike në filmin e Çerçiz Topullit e ka udhëhequr Mihal Grameno. Atë rol, ndërkaq, tek ne e ka pasur Baci Hamzë...". Shembujt e ndjekur nga Adem Jashari kanë qenë tribunët, prej tyre, ashtu si nga i ati, ai mësoi përbalimin e të gjitha dhimbjeve të botës, vuajtjeve të mëdha të luftës, mrekullisht pa e njohur dëshpërimin.

Dalëngadalë, natyrshëm, ndodhi një fenomen tjetër. Asnjë njeri tjetër, më shumë se sa ai, nuk ngërthente në vetvete kaq shumë persona të mbledhur rreth një

qendre, u bë i shumëlojtë dhe i shumëfishtë. Ndërsa ai mbledh rreth vetes figurat mitike të së shkuarës, drejt tij shkojnë të tjerët, pasi e ndjejnë se kanë nevojë për të, se u duhet shembulli i tij, qëndresa që u afron, siguria që ua jep. Miq të tij të luftës do të jenë të gjithë ata që e kanë bërë në mend të luftojnë, dhe kur e fillojnë luftën, atëbotë kalojnë në stadin tjetër, të bashkëlufetarit.

Drejt tij shkojnë fillimisht prekazalitë, që janë më afër se të tjerët, të fisit të tij të Jasharëve, apo të lagjeve të tjera të Prekazit të Poshtëm, Kodralitë, Lushtakët, Mehajt, me to dhe përmes tyre, ai do të krijojë çetën e parë, pastaj grupin e parë. I strukturuar në lëvizjen ilegale çlirimtare, ai do të rritë veten pastaj nëpër Drenicë, do të shkojnë drejt tij djemtë e rinj dhe burrat. Fillimisht do të jetë një ujëvarë lirie, do të kthehet pastaj në lum që rrjedh drejt lirisë, për t'u kthyer në det lirie. Si eci ai përmes tri hallkave do e themi më pas, por e rëndësishme ishte se ai i besoi që në fillim ujëvarës së lirisë dhe u përgatit për hapat e mëtejshëm.

Drejt tij shkon Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, njëri drenicas dhe tjetri nga Mitrovica, rrethi hapet, i pari ngulmon në qendrën e lëvizjes ilegale çlirimtare se, domosdo, duhet bërë furnizimi me armatim i grupit të Drenicës, dhe kjo është në janarin e vitit 1992. Ai do të flasë gjatë me njërin nga drejtuesit e atëherëshëm të Lëvizjes Popullore të Kosovës, Ramadan Avdiun, se duhet bërë me patjetër mbështetja logjistike e grupit të Drenicës, së cilit edhe i takon. Do të shkojnë drejt tij Sylejman Selimi, më pas Rexhep Selimi, Nait Hasani, aty gjejnë strehë Ilir Konushevcit, Adrian Krasniqi, Iliaz Kodra, Abedin Rexha, Luan Haradinaj, Mujë Krasniqi, Daut Haradinaj do të vijë nga Dukagjini, rrethi hapet më tej; tenton të shkojë drejt tij edhe fizikisht Zahir Pajazitit, por i pret rrugën plumbi i pritës serbe; atëherë merr rrugën Rustem Mustafa dhe Rafet Rama, niset drejt tij Fehmi Lladrovci dhe Xheva, ka një ngarendje të vullnetshme. Gjithçka fillon të ndryshojë, ai mbetet i njëjti, njerëzori, me synimin që të pamundshmen, ta bëjë të mundshme. (Vijon)





## Mbi 2 milionë persona të infektuar me Covid-19 në ShBA

UASHINGTON, 11 QERSHOR - Numri i rasteve të konfirmuara me koronavirus në Shtetet e Bashkuara ka tejkaluar shifrën 2 milionë, ndërkohë që autoritetet shëndetësore kanë thënë se janë duke regjistruar rritje të numrit të të prekurve me sëmundjen Covid-19, që

shkakton koronavirusi. Shteti i Arizonas ka raportuar më 10 qershor për rekord të numrit të pacientëve, pasi një grup i madh turistësh janë parë duke qarkulluar përgjatë një feste të shënuar në fund të muajit maj. Teksas, Florida dhe Karolina Veriore, të cilat kanë qenë në

mesin e shteteve të para që kanë lehtësuar masat e izolimit, kanë qenë, po ashtu, në mesin e vendeve që kanë raportuar për rekord të infektiveve të reja brenda një dite. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", ShBA-ja ka konfir-

muar 2 000 464 raste të prekura me koronavirus. Prej tyre mbi 113 000 pacientë kanë vdekur. Këto të dhëna kanë ardhur pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shtuar vëmendjen ndaj rritjes "eksponenciale" të numrit të të infektuarve



me këtë virus në Amerikën Latine.

## Komisioni Evropian propozon hapjen e kufijve për Ballkanin më 1 korrik



BRUKSEL, 11 QERSHOR - Komisioni Evropian ka rekomanduar të enjten hapjen graduale të kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian nga 1 korriku, për shtetasit e huaj, duke marrë parasysh situatën epidemiologjike. Komisioni ka propozuar që masa e ndalimit të hyrjes në BE të hiqet për ato vende të cilat dëshmojnë se situata e përhapjes së koronavirusit është e menaxhueshme.

Në propozimin e Komisionit Evropian, kufizimet është kërkuar që të hiqen për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Bosnje-Hercegovinë dhe Serbi.

Komisioni e ka arsytuar këtë kërkesë, me faktin se "situata epidemiologjike e tyre është e ngjashme apo edhe më e mirë sesa në BE". Sipas tij, ky rekomandim është edhe në përputhje me gatishmërinë e shprehur të

Komisionit Evropian që t'i përfshijë për së afërmi vendet e Ballkanit Perëndimor në zbatimin e udhërrëfyesit për heqjen e masave kufizuese në luftën kundër pandemisë. Aty është përfshirë edhe rekomandimi për rifillimin e punës në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore për dhënien e vizave.

Sa iu përket vendeve të tjera, Komisioni ka propozuar që vendimet të kushtëzohen me situatën epidemiologjike në to, me mundësinë e testimeve, vëzhgimit të personave të infektuar si dhe me kufizimet që kanë ato vende për hyrjen e daljen e shtetasve të BE-së.

Mes të tjerash, është kërkuar që pas 1 korrikut të aplikohen masa lehtësuese për studentët edhe punëtorët sezonalë, si dhe prej datës 15 qershor të hiqen të gjitha kontrollet kufitare mes vendeve të bllokut evropian.

## Lufthansa planifikon mbylljen e 22 000 vendeve të punës

BERLIN, 11 QERSHOR - Linja gjermane Lufthansa ka njoftuar se planifikon mbylljen e 22 000 vendeve të punës teksa tenton ta përballojë rënien e numrit të fluturimeve prej shpërthimit të pandemisë me koronavirus. Kjo kompani ka parashikuar rimëkëmbje të ngadalshme dhe ka theksuar se pret që të ketë 100 aeroplanë më pak pas përfundimit të krizës. Lufthansa ka njoftuar se gjysma e vendeve të punës do të mbyllen në Gjermani dhe shpreson që të arrijë marrëveshje me sindikatat deri më 22 qershor. "Qëllimi është që t'i hapim rrugë ruajtjes së vendeve të punës, sa më shumë që mundemi në Grupin Lufthansa", ka njoftuar kjo kompani. Kjo linjë ajrore punëson më



shumë se 135 000 persona në gjithë botën.

Shumica prej tyre janë në Gjermani.

Drejtori për Punë në Lufthansa, Michael Niggemann, ka thënë: "Pa ulje të konsiderueshme të shpenzimeve të personelit gjatë krizës, ne do ta humbim mundësinë për një rikthim më të mirë pas krizës dhe rrezikojmë që Grupi Lufthansa të dalë nga kriza më i dobët".

Muajin e kaluar kjo kompani ka nënshkruar marrëveshje me Qeverinë gjermane në vlerë të 9 miliardë eurove, me qëllim të ikjes nga shkatërrimi.

Qeveria gjermane do të menaxhojë 20 për qind të aksioneve të kompanisë të cilat tenton t'i shesë deri në fund të vitit 2023.

## Në Turqi rifillojnë fluturimet ndërkombëtare

STAMBOLL, 11 QERSHOR - Një rifillim gradual i fluturimeve ndërkombëtare nga Turqia ka filluar, pas dy muajve ndërprerje për shkak të pandemisë nga Covid-19. "Turkish Airlines" ka njoftuar të enjten fluturimet e

para drejt Dyseldorfit, Mynihut dhe Frankfurtit në Gjermani, si dhe drejt Londrës dhe Amsterdemit që nga aeroporti i Stambollit. Avioni i parë me destinacion Londrën u ngrit të enjten në mëngjes nga aeropor-

ti "Sabiha Gokcen", në anën aziatike të metropolit të Bosforit. "Fluturimet ndërkombëtare kanë filluar në mënyrë të kontrolluar. Duke nisur nga 15 qershori, fluturimet do të rifillojnë rregullisht drejt vendeve jo të

kërcënuara", ka thënë ministri i Transporteve, Adil Karaismailoglu. Megjithatë, gjatë orëve të fundit ka pasur pakënaqësi për pasagjerët që udhëtonin në Turqi nga aeroportet evropiane.





# Kadare, fitues i 'Prozart 2020'

Çmimi "Prozart", që festivali internacional i letërsisë "PROZA Ballkan" i akordon autorit të shquar, për kontributin autorial në zhvillimin e letërsisë së Ballkanit, këtë vit i takoi shkrimtarit të madh shqiptar, Ismail Kadare, për opusin e tij imponant shumëvjeçar romancier dhe eseistik, i cili, rregullisht shkakton jehonë të madhe në kritikën evropiane dhe atë botërore.


Për shkak të pamundësisë që festivali të mbahet në terminin e zakonshëm (në fund të majit), laureati e mori çmimin, i cili përbëhet nga statuja dhe pjesa monetare, në shtëpinë e tij në Paris. Organizuesit paralajmërojnë se edicioni i tetë i festivali do të mbahet në vjeshtë.

Në arsyetimin e këshillit për ndarjen e çmimit "Prozart", të cilin e përbëjnë, Ermis Llafazanovski – kryetar, Aleksandar Prokopiev dhe

Dejan Trajkovski – anëtarë, thuhet se në krijimtarinë prozaike të Kadaresë ndërthuren e kaluara dhe bashkohorja, miti dhe ironia, individualja dhe kolektivja, të bartura në idiomë shumë specifike, karakteristike, stilistike dhe gjuhësore, që e veçojnë veprën e tij në grupin e kolosëve bashkohorë botërorë të letërsisë.

"I papërmbajtshëm ndaj ndershmërisë së shkrimtarit, por edhe qëndrimit intelektual me kapacitet imagjinar të pashtershëm, Kadare vazhdimisht gjatë gjysmë shekulli krijimtari i befason njohësit e letërsisë me përpunimin e lartë letrar në tema në të cilat bashkëveprojnë lokalja dhe universalja", – thuhet në vlerësimin e këtij këshilli.

Nga ana tjetër, Kadare përmes një letre, ka shprehur falënderim për mirënjohjen e njëherësh edhe pikëllim për pamundësinë për ta pranuar çmimin person-



alisht.

"Kuptohet se më paraqet rëndësi të madhe që çmimi 'Prozart' e madhështon letërsinë e Ballkanit dhe jam i nderuar që bëj pjesë në shoqërinë e laureatëve të deritanishëm të kësaj mirënjohjeje. Lexuesit e veprave të mia,

ndoshta fillimisht më kanë konsideruar shkrimtar shqiptar dhe kjo është mjaft e arsyeshme. Ata ndoshta më konsiderojnë edhe autor i cili hulumton ngjarje të caktuara të historisë të cilat nuk janë të rëndësishme vetëm për rajonin ballkanik, si Shekspirin, tragjedinë greke, Luftën e Dytë

Botërore, aferën Pasternak. Mund të shtoj se letërsia e Ballkanit është letërsi globale sepse aq shumë autorë ballkanikë, duke më përfshirë edhe mua, lexohen me përkthim. Aq më tepër, çështjet tona rajonale janë çështje globale, ku për shembull, përfundon Evropa? Nuk bëhet fjalë për çështje, në të cilën letërsia e Ballkanit apo cila do tjetër, mund të përgjigjet me definicion, por është çështje në të cilën letërsia dhe historia u treguan fascinante. Shpresoj se lexuesit do ta shfrytëzojnë mundësinë të zhyten në letërsi në këto momente të pakëndshme", ka shkruar mes tjerash, në letrën e tij, Kadare. Ismail Kadare është autor i shumë librave të njohur ndërkombëtarisht, mes të cilave "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kështjella", "Ura me tri harqe", "Piramida", "Trashëgimtari". / Konica.al

## Teatri i famshëm gjerman, Multimedia dhe Teatri Kombëtar i Kosovës bashkëpunojnë për 'Kthimin e Karl Majit'

Teatri i famshëm gjerman Volksbühne nga Berlini është duke bashkëpunuar me Qendrën Multimedia dhe Teatrin Kombëtar të Kosovës, për të realizuar shfaqjen "Kthimi i Karl Majit" (Shfaqje argëtuese për popullin gjerman), e cila do të prezantohet si ekstrakt teatror online gjatë festivalit POSTWEST. Festivali do të mbahet nga data 24 – 26 qershor në Berlin, në teatrin Volksbühne.

Ndërkohë, shfaqja e plotë, si realizim skenik do të jepet në shtator, në Teatrin Kombëtar të Kosovës, pastaj pritet të nisë turneun ndërkombëtar.

Regjinë e shfaqjes "Kthimi i Karl Majit" është duke e bërë Blerta Neziraj, kurse luajnë aktorët: Arta Muçaj, Armend Smajli, Edona Reshitaj, Adrian Morina, Ylber Bardhi dhe Shpetim Selmani. Tekstin e ka shkruar Jeton Neziraj, videon është duke e realizuar Ilir Gjocaj kurse bashkëpunëtor artistik është Alban Beqiraj.

### Rreth shfaqjes "Kthimi i Karl Majit"

Kara Ben Nems, personazhi i njohur i Karl Majit, arratiset nga Lindja dhe, bashkë me një grup aktorësh nga Kosova, ia mësynë 'tokave gjermane'. Në këtë udhëtim gati epik, ai takon Slavoj Zhizhekun, Piter Handken, një pjesëtar të Nationalsozialistischer Untergrund e të tjerë. Shfaqja e konfronton publikun me qasjen

gati demonizuese të Evropës Perëndimore – superioritetin e supozuar kulturor, politik e intelektual të saj ndaj Lindjes për të cilën Aleksandar Hemon thotë se i ka rrënjët thellë në kolonializëm dhe racizëm.

### Rreth festivalit Postwest

I planifikuar të mbahet në maj të vitit 2020, festivali transkulturore i teatrove POSTWEST synonte të mbledhte artistë nga dhjetë shtete të cilët kishin zhvilluar dymbëdhjetë shfaqje të reja enkas për këtë festival. Me historinë e vet dramatike ndërmjet perëndimit e lindjes, Volksbühne është vendi ideal për këtë mbledhje të profesionistëve teatrorë nga Evropa Lindore. Tani të gjithë teatrot me të cilët jemi partnerë kanë gjetur veten në një realitet të ri. Për ne, si ekupe artistike, pandemia COVID-19 nuk ka nënkuptuar vetëm anulimin e javës së festivalit në maj, por gjithashtu edhe përfundimin e papritur të fazës përgatitore: provave për produksionet tona të cilat ishin në prag të fillimit, pjesa jonë e skenografisë në Großes Haus ishte krijuar tashmë në punëtoritë e Volksbühne dhe orari për secilën ditë të festivalit tashmë ishte përfunduar.

Pas një viti përgatitjesh, si do të bëhej që ky festival transkulturore teatror, të ndodh pas një paralajmërimi kaq të befutë dhe pa asnjë produksion apo skenë reale të përfunduar? Duke u rikthyer në konceptin bazik të festivalit, atë



të shkëmbimit kolektiv artistik. Përgjatë javëve të fundit, kemi shtuar këtë bashkëpunim i cili i ka sjellë teatrot tanë partnere në Berlin për tri punëtorë që nga qershori i vitit 2019. Në vend të Volksbühne, po e shfrytëzojmë hapësirën virtuale për të shpërndarë ide tej-përtej kufijve – dhe kështu edhe një hapësirë për edicionin virtual të POSTWEST.

Dymbëdhjetë produksionet e planifikuara tani do të zëvendësohen me kontribute dixhitale që reflektojnë natyrën e rrjetit tonë ndërkombëtar, i cili do të bëhet i qasshëm për një audiencë globale për herë të parë për tri ditë me rradhë: performanca drejtpërdrejt online, video me pagesë, audio materiale dhe diskutime me profesionistë teatri rreth përvojave të tyre me POSTWEST. Kjo do të plotësohet nga formate shtesë përmes programit tonë mbështetës i cili në nëntor të vitit 2019 ka filluar me një numërim tematik për së prapthi deri në ditët e festivalit. Ky program përfshin ngjarje tematike siç janë seritë Plattform East, takime me artistë dhe sete

muzikore (DJ set) – natyrisht, të gjitha në mënyrë dixhitale.

Kështu POSTWEST ka tejkuluar veten si ngjarje që ndodh në skenë dhe tash po i përgjigjet realitetit të ri. Kriza e Koronavirusit na ka mundësuar të observojmë se si shumë shtete po kthehen tek vetja përsëri dhe informacioni për situatën në shtetet tjera duket thjesht sikur statistikë. Përkundër kësaj prapavije, reflektimi mbi kategoritë historike dhe mundësitë për shpërbërjen e tyre bëhet më i rëndësishëm se kurrë më parë. Lindja apo perëndimi? Post-perëndimi, post-lindja, post-lindje-perëndimi? A çon trashëgimia e përbashkët kulturore drejt një vetëdijeje të ngjashme historike? Me një llojlojshmëri kaq të madhe shtetesh e identitetesh, a është e mundur të mendojmë dhe formësojmë një të ardhme së bashku? Çka nënkuptojnë për neve një shoqëri e fuqishme civile, solidariteti, vlerat relevante për të ardhmen dhe sistemet demokratike? Si mundemi ne, si profesionistë teatri – edhe përg-



jatë një izolimi botëror dhe pa asnjë mbledhje publike – të vazhdojmë të formësojmë rrjetet e nisma afatgjata transkulturore në mënyrë që artistikisht t'iu përgjigjemi këtyre debateve aktuale.

Ndërkohë që edicioni virtual i festivalit adreson këto pyetje, ai gjithashtu formëson bazën e një rrjeti ndërkombëtar. Produksionet e planifikuara do të kenë premierat dhe do të përfshihen në repertoaret e teatrove tanë partnerë sapo atë të rihapen. Në këtë mënyrë, dhe përmes bashkëpunimeve të ardhshme, POSTWEST vazhdon të jetojë si hapësirë ku disiplinat artistike nuk shikohen vetëm nga një perspektivë individuale e kombëtare, por gjithashtu krijojnë një kontekst transkulturore.

Financuar nga: German Federal Cultural Foundation, Ministry of Culture of the Republic of Kosovo, Goethe-Institut, The Olof Palme International Center, Rockefeller Brothers Fund, Swiss Agency for Development and Cooperation, European Union Office in Kosovo.



E jashtëzakonshme

## Këpucari rumun krijon këpucët anti-Covid

Distancimi social ka qenë një ndër rregullat kryesore që është kërkuar nga autoritetet shëndetësore në mbarë botën për ta parandaluar përhapjen e virusit të ri Covid-19. Shumë njerëz janë përpjekur të gjejnë zgjidhje për të zbatuar këtë rregullar duke krijuar kapele të çuditshme apo veshje të ndryshme për ta mbajtur larg personat e tjerë në distancën e kërkuar nga autoritetet. Një këpucar rumun ka sjellë risinë e fundit në listën e objekteve të krijuara për ruajtjen e distancimit social. Duke parë se shumë



njerëz me dashje ose jo nuk e zbatojnë këtë rregull ai ka prodhuar një lloj të ri këpucësh me zgjatime përpara përtej normales për parandaluar afrimin mes njerëzve duke parandaluar kështu, sipas tij, përhapjen e koronavirusit.

## BARSOLETA E DITËS



Një grua po i ankohej mjekut:  
- Djali im është mjaft i sëmurë. Ka dhimbje të forta në bark.  
- Çfarë ka ngrënë?  
- Njëfarë fiqi tha, e ai ishte i mbushur me miza.  
- Jepi ilaç mizash dhe qetësohet.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

## Vonohet 'Deadpool 3', fajësohet 'Marvel'

Krijuesi i filmave "Deadpool", Rob Liefeld, e ka fajësuar studion "Marvel" për vonimin e fillimit të punës rreth vazhdim-it të tretë të këtij projekti. "Deadpool 2" ishte lansuar në vitin 2018, derisa në dhjetor të vitit të kaluar protagonist i këtij filmi, Ryan Reynolds, e kishte konfirmuar lajmin se filmi i tretë ishte në realizim e sipër nga studioja "Marvel". Duke folur për vazhdimin e tretë të këtij projekti, të cilin definitivisht e kishte paralaj-

jmëruar për fillim të vitit 2019, krijuesi Rob Liefeld e fajësoi studion e famshme "Marvel" për vonesat e vazhdueshme. "Marvel" është përfshirë në realizimin e filmave "Deadpool", pasi studioja prapa realizimit të tyre, "Fox", u ble nga kompania "Disney", transmeton Koha. Ndërkaq, ylli hollywoodian, Ryan Reynolds citohet të ketë thënë: "Po, bashkë me tërë ekipin aktualisht jemi duke punuar rreth këtij filmi".

# DEADPOOL



FOTO E DITES




Me rastin e 21-vjetorit të Çlirimit të Prishtinës, Orkestra Frymore e FSK-së parakaloi të enjten në sheshin 'Nëna Terezë'. /ER/

E rrallë

## Burri ulet aksidentalisht në një peshk, kafsha i futet në zorrë të trashë

Një burrë 30-vjeçar në Kinë ka hequr një peshk të tërë nga rektumi i tij, pasi dyshohet se ishte ulur aksidentalisht në të. Pacienti kishte shkuar në spital për dhimbje të forta të barkut, shkruan 9Gag. Pacienti pretendoi se peshku rrëshqiti në rektumin e tij pasi ishte ulur aksi-



dentalisht në të, sipas dr. Zeng Weigen nga Spitali i Pekinit Chaoyang, Universiteti Capital Medical. Mjekët duhej ta hapnin barkun e burrit për t'ia hequr peshkun e ngordhur nga rektumit. Mbetet e paqartë nëse është shëruar plotësisht pacienti.



**DASHI**

Sot ju nuk do të jeni në gjendje të largoheni, duke u fshehur pas dikujt tjetër ose duke u përpjekur të qëndrosh në vetmi.



**DEMI**

Ju duhet të përcaktoni se cila është gjëja më e rëndësishme në jetën tuaj, ose ndryshe mund ta bëni gabimin e vendosjes së karrocës përpara kalit.



**BINJAKËT**

Dikush nga e kaluara juaj është kthyer sërish dhe po vepron mbi supozimet e vjetra rreth asaj se kush jeni ju.



**GAFORRJA**

Ditët e errëta të së kaluarës nuk do të kthehen për t'ju ndjekur nga pas. Një ide e re do të vijë në jetën tuaj dhe do të digjet me shkëlqim.



**LUANI**

Një pjesë e juaja, e cila dëshiron të kalojë të gjithë kohën me njerëz të tjerë, po lufton për kontrollin me pjesën e tjetër.



**VIRGJËRËSHA**

Është një ditë e mrekulueshme për të bërë parashikime. Aftësia për të kuptuar se çfarë po ndodh është e fortë.



**PESHORJA**

Përdorni intelektin tuaj shumë më tepër nesër dhe lëreni mënjanë sensin e humorit për momentin. Njerëzit duhet të dëgjojnë atë që ju me të vërtetë mendoni për çështje të vështira.



**AKREPI**

Filloni të investoni më shumë rreth pamjes suaj të jashtme. Kështu do të krijoni opinion më pozitiv nëse jeni duke aplikuar për një vend pune.



**SHIGJETARI**

Përpara se t'i deklaroni projektet tuaja, përpikuni të hulumtoni në maksimum nëse ato janë të realizueshme.



**BRICJAPI**

Duhet të ndërmerri një udhëtim që do të rezultojë relaksues. Përpikuni ta shijoni dhe të mos mendoni aspak për angazhimet në punë.



**UJORI**

Një projekt i fundit i juaj është më afër përfundimit nga sa e keni menduar. Nëse keni kohë për ta pastruar hapësirën tuaj të punës, bëjeni.



**PESHQIT**

Është e rëndësishme që mendimet t'ju dëgjojen. Tani po e analizoni botën me shumë efektivitet. Vazhdoni dhe përfitonin nga vrulli i fortë që keni ndërtuar.



## Çfarë po ndodh në mes të Kidës dhe Mozzikut?



**K**anë kaluar mbi katër vjet që nga bashkëpunimi i parë dhe i fundit mes Kidës dhe Mozzikut. Kënga "Premtimet" menjëherë pas publikimit u shndërrua në hit për muajt të tërë dhe sigurisht që nuk ka munguar as në listën e 100 këngëve më të bukura moderne shqiptare.

Duket se diçka po ndodh mes dyshes së artistëve, pasi pak orë më parë ata kanë postuar foto të njëri-tjetrit në "Instagram", detajet e të cilave janë të ngjashme. Asnjëra prej tyre nuk ka një përshkrim, e të dy këngëtarët kanë mbuluar një pjesë të fytyrës së tyre me duar teksa qëndrojnë gjysmë të ulur.

## Kylie tërheq vëmendjen



Nuk do shumë mund që të gjithë t'i kenë sytë tek ajo, pasi kudo ku shkon Kylie Jenner tërheq vëmendjen e njerëzve dhe paparacëve. Mbrëmjen e së mërkurës miliarderja 22-vjeçare, e shoqëruar nga babai transgjinnor Caitlyn, e disa miq të saj,

ka kthyer kokat e kalimtarëve me "lookun" e saj tepër elegant. E veshur me një pallto të gjatë, me flokë të kapur bisht e syze dielli, ylli i "Keeping Up With The Kardashians", dukej si një zonjushë e tepër e sofistikuar.



## Angelina Jolie ndan historinë e trishtuar që e ka mbajtur të fshehtë

Në një intervistë për "Vanity Fair", aktorja hollivudiane Angelina Jolie ka treguar për herë të parë një histori të trishtuar dhe shumë personale. Ajo rrëfeu se përse e quajti vajzën e saj të parë Shiloh, e cila tani është 14-vjeçare dhe shumë e lidhur me të dy prindërit e saj. "Pas emrit Shiloh fshihet një histori shumë e trishtuar. Me këtë emër unë regjistrohesha nëpër

hotele kur udhëtoja në mënyrë që askush të mos e kuptonte që isha unë. Emri që përdorja ishte Shiloh Baptist", ka treguar e emocionuar ylli i Hollivudit. Më pas ajo tregoi se Shiloh Baptist do të quhej fëmija i parë i prindërve të saj, por që foshnja nuk u pagëzua kurrë me këtë emër pasi mamaja e saj dështoi gjatë shtatzënisë.

## Për shkak të Covid-19, anulohet turneu "Love on Tour" i Harry Styles



**K**ëngëtarëve kudo në botë u janë anuluar koncertet. Njësoj ka ndodhur edhe me Harry Styles i cili ka qenë i detyruar ta anulojë turneun në Amerikën e Veriut për shkak të parandalimit të Covid-19. "Këtë verë ishim të ngazëlyer që po sillnim 'Love On Tour' në

Amerikën e Veriut. Sidoqoftë, për shkak të përhapjes së vazhdueshme të Covid-19, u detyruam të caktojmë datë tjetër për vitin e ardhshëm. Unë mezi pres t'ju shoh të gjithëve në rrugë sa më shpejt që është e sigurt për ta bërë këtë", është shprehur Harry Styles.



Ese



## Andon S. Frashëri i fundmi i dishepujve të Nolit

Kam vite të tëra që mbart në kujtesë emrin e shkrimtarit, publicistit dhe shqipëruetit Andon S. Frashëri. Në vitin 1964, vajzë e re, kur sapo pata kryer studimet e larta u emërova mësuese e gjuhës angleze në gjimnazin e Korçës, dhe unë për herë të parë e jepja këtë gjuhë të huaj në atë qytet. Që në muajin e parë pasi pata filluar punë, një ditë pas orëve të mësimit një nxënisi im (më vonë i shkëlqyer në mësim), Aleks Jani, shtatpakët me kaçurrela të verdha m'u afrua i ndrojtur i skuqur në fytyrë duke më thënë se një burrë, që dinte anglisht donte të më takonte, kështu më shpuri tek shtëpia e Andon Frashërit.

Ajo ishte një shtëpi e vjetër me portën e jashtme të rrënuar prej viteve, kishte një oborr dhe pasi ngjitje disa shkallë hyje tek një portë tjetër, e cila rrinte gjithnjë e hapur, sepse aty banonin edhe disa familje të tjera e në njërin prej dyerve djathtas jetonte Andon Frashëri, në një dhomë jo shumë të madhe me mure të çiflosur me libra gjithandej dhe tavani që kish lëshuar bark. Ai pat lindur në këtë shtëpi, kjo ishte shtëpia e prindërve të tij. Kështu filloi miqësia ime me Andon Frashërin. Mësova se ai

pat qenë për shtatëmbëdhjetë vite radhazi sekretar i Imzot Fan Nolit më 1924, kur ai pat qenë kryeministër i Shqipërisë ndërsa më parë veprimtar në shoqërinë "Vatra" të Amerikës njëkohësisht gazetar dhe botues i gazetës "Dielli", Andon Frashëri shkruan: "Në vitin 1915 emërohem ndihmësi i tij si nëndrejtor i gazetës "Dielli". M'u duk ahëre sikur kapa Perëndinë me dorë. Dhe vjetët që rodhën në bashkëpunim me të më dhanë rast ta njoh Nolin me rrënjë e degë... Me Nolin si udhëheqës puna më e rëndë bëhet më e lehtë se penda, më e ëmbël se mjalta. Pa gënjeshtëri ai të inspiron, të frymëzon, të jep zemër."

Ne bisedonim të dy për librat që unë lexoja, ai më tregonte letrat, librat, fjalorët, që i dërgonte Noli dhe hera herës ndonjë çek të vogël në raste Krishtlindjesh apo Pashkësh dhe gjithnjë prapa zarfeve shkruhej një adresë tjetër me një emër femre "Mary", (ndoshta përdorej emri i sekretares së Nolit, Mary Johns) apo ndonjë mbiemër tjetër i sajuar që të mos kuptohej se ata të dy mbanin letërkëmbim, kushedi edhe përmbajtja e letrave do të ish e tillë që të merrej vesh vetëm prej atyre të

dyve. Unë i prekja me dorë letrat, librat e më dukej sikur takoja dorën time me dorën e të madhit Fan Noli mijëra kilometra larg. Më tej ne të dy bisedonim për mrekullinë e shqipërimeve të Nolit: dramat e Shekspirit, "Rubai" të Omar Khajamit, poemën "Skënderbeu" të H. Longfellowit me vargjet brilantë: "Lufton luftën dhe fiton / Mbreti Ladislav gjëmon..." e të tjera. Miqësia ime me Andon Frashërin ishte një miqësi paksa e trembur, e përndjekur ndoshta. Më treguan të tjerët ose ai vetë se pat qenë dhjetë vjet në burg politik pas çlirimit, por për këtë gjë unë nuk e pyesja e nuk bisedonim e kështu vijoja ta vizitoja. Edhe bashkëshortja e tij rumune, Maria, (Meri) u arrestua dhe bëri dy vjet burg, duke qenë e mbyllur brenda në burg ajo bëri dhe një përpjekje për të vlarë veten. Më vonë pas lirimit, aty nga viti 1959 Zonja Frashëri u largua nga Shqipëria për në Rumani duke e lënë Andonin fill të vetëm dhe pa fëmijë. Në burg Andoni kish operuar stomakun dhe për pasojë kishte shumë probleme me të ngrënit e ushqimeve. Pasditeve, aty në dhomën e tij të vogël u jepte mësim të

gjuhës angleze disa intelektualëve të qytetit dhe disa vajzave korçare të prekura nga regjimi komunist. Mbaj mend se më mbajti një ditë për drekë, ishin Krishtlindjet e të dy trokitëm nga një kupë me verë të kuqe. Andoni ishte tepër i përkorë në sjellje dhe më trajtonte sikur të isha e barabartë me të për nga shkalla e njohurive. Unë pata qenë studente e Skënder Luarasis dhe asokohe dija aq shumë vargje përmendësh të Nolit, të shqipërimeve të tij të mrekullueshme si edhe dija diçka për burra të tjerë të shquar të kombit tonë, që u përpoqën për të bërë Shqipëri. Atje përmbi oxhakun e dhomës së tij në vend që të mbante ndonjë ikonë (se ende nuk ishim bërë i vetmi vend ateist në botë), ai mbante një fotografi të madhe të Fan Nolit dhe i ndizte kandilen me vaj të kremteve. Fan Noli ishte idhulli i jetës së tij. Po aty mbi oxhak pashë për herë të parë librin e Nolit "Psalme", ai më pat treguar një fjalor të madh anglisht Webster me të cilin punonte, librin "Betoveni dhe Revolucioni Frëng" në anglisht e të tjerë libra. Nuk guxoja të kërkoja libra për të lexuar, po ashtu ai kurrë nuk më tregoi

për librat që pat shkruar vetë, të cilat u zhdukën nga çarkullimi kur Andonin e futën në burg, kështu ishte autor i ndaluar. Tek libri "Fanoliana" i Prof. Nasho Jorgaqit lexojmë një letër të Andon Frashërit dërguar Nolit më 4.3.1938 ndër të tjera: "Imzot, ... ashtu siç priste Shqipëria një kohë Skënderbejnë, po me atë mall ju presim edhe ju sot... Shqipëria sot ka nevojë për patriotë si ju. Kujtoni pastaj se kini edhe detyrë kundrejt shokëve të vjetër; këta me ardhjen t'uaj do bëhen burra. Këtë nuk e thom për vehten time, po për shokët, të cilët me çdo rast pyesin me ngashërim për ardhjen t'uaj. Bashkimi juaj me Faiknë na ka prekur; ish i domosdoshmë dhe s'ka dyshim se të dy kolonat të lidhura tok janë për ne garancia më e madhe..."

Vite më parë në arkivin e qytetit të Pogradecit pata ndeshur në faqet e një reviste, të cilën e botonin intelektualët e kohës në vitet '20-të, një fotografi të Andon S. Frashërit dalë kokë më kokë me Bahri Omarin. Në librin e Enver Hoxhës "Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re" pikërisht në faqen 106 kam lexuar: "Fazlli Frashërin e shihje pasdreke, dimër e



behar... duke biseduar me të njëjtët profesorë të Liceut të Korçës... me Andonaqkën e Frashërit, agjent i amerikanëve dhe imoral.”

**Po në librin “Fanoliana” lexojmë një tjetër letër të gjatë të A. Frashërit dërguar F. Nolit:**

Tiranë 28.9.1945 I dashur Imzot. Prej disa muajsh më parë ju pata dërguar një letër, me anën e së cilës ju lutesha – në emër të shokëve – që të ndërmeretsonit pranë Qeverisë këtu për shpëtimin nga vdekja e të ndjerit Kol Tromara e B. Omari, të cilët u dënuan dhe u ekzekutuan së bashku me Akif Përmetin, Dhimitër Balën, Haki Tatzatin, Zejnel Gjolekën, Xheneral Mirdaçin, Fejzi Alizotin, Toçin etj. Kam dyshim në ju ra në dorë.

Gjendja e këtushme... Fuqinë në dorë e ka qint për qint Partia Komuniste me Enver Hoxhën, Koçi Xoxen, Sejfulla Malëshovën, Bedri Spahiu, Mehmet Shehun etj. këta janë në bashkëpunim të plotë me Titon... Gegët nëmërohen me gisht dhe po bëhet një propagandë katastrofale toskë-gegë dhe kaur e turq! Shkabën me dy krerë e mbuloi Hyll'i kuq. Propagandën e bëjnë haptazi, duke mos lënë rast pa ekzaltuar edhe lajmën më të vogël që vjen prej Beligradit ose Moskës dhe duke vogëluar çdo gjë që rrjedh nga Perëndimi.

Ndërsa në letrën e datës 30.1.1964 Andoni i shkruan Nolit me një ton të përmbajtur duke u ankuar për shëndetin dhe pleqërinë dhe natyrisht duke shprehur mendime për libra të ndryshëm që kanë lidhje me ata të dy.

Së fundi vajta në Bibliotekën tonë Kombëtare dhe mora për të lexuar librat e A. Frashërit, sapo hapa librin e parë romanin “Patrioti” me 160 faqe botuar në Korçë në vitin 1933, mu në faqen e parë më zuri syri një vulë ku lexohej “Mitrush Kuteli Biblioteka” (do me thënë) se ky libër i paskërka përkitur shkrimtarit Dhimitër Pasko dhe në krye të faqes një kushtim: “Z. Mitrush Kuteli me miqësi A. Frashëri”, për një çast pata një vegim sikur po i shihja të dy shkrimtarët tek po shtrëngonin duart me njëri tjetrin. Romanin e tij “Patrioti” autori ua kushton “Dëshmorëve të kombit që dhanë me gëzim jetën e tyre për idealin kombëtar ua dedikoj këtë vepër të vogël për kujtim.” Ky roman është i bazuar në faktet e ngjarjeve të viteve të fillimshekullit të njëzetë, ato luftëra të turbullta të Shqipërisë në ato vite e sidomos në qytetin e Korçës dhe rrethinave të saj. Libri i kushtohet atdhetarit Themistokli Gërmenji, i cili u vetëflijua që të bëhej Shqipëria. Për Themistokli Gërmenjin Lasgushi më ka thënë këto vargje: “Tha të tri fjalët dhe

mbaroi / Dhe shpejt jep urdhër: Zjarr! / Atje ku bie vdes heroi / Rilind Atdheu Shqiptar!”

Libri “I funtmi i Kastriotëve” botuar në Tiranë nga Botonjësi Ismail Mal’Osmani në vitin 1944 përbëhet prej 113 faqesh. Këtë roman Andon S. Frashëri ia kushton: “Fan S. Nolit Kalorësit të Letërsisë Shqipëtare si shenjë mirënjohjeje Dishepulli i Tij”. Në këtë libër autori me zjarrin e zemrës shkruan për ngjarjet që vijuan në kombin tonë pas vdekjes së Kryetrimt Gjergj Kastriotit, për birin e tij të vetëm Gjonin dhe kryengritjet që zunë fill në Krujë për ta shpëtuar Shqipërinë nga zgjedha turke e ndonëse shumë

trima luftuan e ranë në shesh të betejës nuk mundën dot të fitojnë sepse u tradhtuan nga shqiptarët e shitur tek turqit për grada e ofiqe. Megjithëse libri mbaron në mënyrë tragjike vështrime të vërtetën drejt e në sy e jemi krenarë për birin e vetëm të Skënderbeut i cili kreu me nder detyrën ndaj Atdheut.

Andon Frashëri shkruhet edhe si shqipëruer i librave “Kapedani i jeniçerëve ose Skënderbeu” shkruar prej Xhejms Ludllout, fillimisht botuar si shtojcë letrare tek gazeta “Dielli”, më vonë botuar si libër më vete në Korçë nga Libraria “Drita” në vitin 1934 (dhe ribotuar në vitin 1967 në

500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut), kësaj here me titullin “Konstandini dhe Morsinia”, përsëri tema e librit është për Kryeherin tonë Gjergj Kastriotin. Po kështu ai ka përkthyer edhe librin “Pavli dhe Virginia” të autorit Bernardin de Sen Pierre.

Në një letër dërguar A. Frashërit prej F. Nolit më 30 maj 1964 botuar tek “Noli Vepra 6” midis të tjerash shkruhet: “Katër vjetët e fundit po mësoj hebraishten, me qëllim që të përkthej Dhjatën e Vjetër nga origjinali dhe për këtë po punoj tani. Deri më sot kam përfunduar Psallmet dhe do t’ju dërgoj një kopje të tyre. Lexojeni librin dhe më

shkruani se çfarë mendoni për të.” Dhe ja se çfarë ka shkruar A. Frashëri për F. Nolin tek Revista “Shkëndija” 1942 Nr. 9-10: “Ata që kanë patur fatin ta dëgjojnë – shkruan një dëshmitar, që e ka ndjekur ecurinë triumfale të oratorisë noliane – nëpër mbledhje, në kishë, ose parlament, të huaj e shqiptarë këtu dhe jashtë kanë dalë të entuasizuar prej forcës së oratorisë së tij. Fjalimet e Nolit të drithërojnë e të japin zemër, këtu të ngrejne në qiell, aty të përplasnin për tokë, të ndezin e të ndërsejnë gjer në frenezi, të fanatizojnë deri në marrëzi, po edhe të zbusin e të qetësojnë dhe dendur të bëjnë të qeshësh dhe të derdhësh lot gëzimi... Fjalën e tij ai e shoqëronte me një buzëqeshje të mbaruar, me një takt njerëzor, dinte të krijonte komunikim me auditorin.”

Një ditë i vajta në shtëpi, porta e së cilës mbante numrin 13 dhe e gjeta Andon Frashërin të sëmurë në shtrat. I shtrydha dy portokalla që ndodheshin mbi tryezë dhe ia dhashë lëngun për ta pirë aty ishte edhe receta për ilaçe prej mjekut. Vajta në barnatore dhe ia bleva, ai ndihej nervoz i pafuqishëm. Nuk dija çfarë të bëja më tepër. Atë pranverë pas vdekjes së Nolit më 13 mars 1965, Andon Frashëri u shtrua në spital. Vajta për ta takuar tok me një shokun tim profesor gjimnazi. Sytë e tij u përletën nga mallëngimi: “Shiko këtu – më tha – numri i krevatit ku jam shtruar është 13, Noli ndërroi jetë më datë 13 edhe unë do të vdes së shpejti... e si mund të jetoj kur ai nuk është më në këtë jetë!...”


Kjo ishte biseda jonë e fundit. Një ditë të vrenjtur me shi tekса ecja bulevardit të Korçës më ndali tek anësorja e rrugës një mikështa ime, Irenë Mëria, gjyshja e saj ka qenë motër e Andonit, dhe më dha lajmin: “E ke marrë vesh, xhaxhi Andoni na vdiq!” Dhe pas pak kohësh ato gjëra të pakta që patën mbetur nga librat dhe dorëshkrimet e Andon Frashërit u mbartën tek një nipi i tij në Tiranë. Në një bllok të rëndomtë nga ata që përdoren nëpër magazina për hyrje dhe dalje malli, Andoni pat shkruar nja 130 faqe por u gjetën të grisura me përjashtim të pesë a gjashtë fletëve. Kaq munda të marr vesh unë.

Dimrin pas vdekjes së tij unë tërhoqa në Bibliotekën e Korçës librin “Betoveni dhe Revolucionari Frëng” (këtë kopje Noli ia pat dërguar Dhespotit të Korçës e në faqen e parë me dorën e Tij pat shkruar disa fjalë për të), u ula dhe e përktheva me një frymë në kujtim të Fan Nolit dhe Andon Frashërit (nuk u botua asokohe ndonëse ndenji dy vite në Ndërmarrjen Botuese “Naim Frashëri”).

Duke shkruar këto radhë mendoj se po ndez një qiri për shpirtin tënd, Andon Frashëri!







**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Milicaj, Feronikelit: Mos eja në Klinë për fitore

Pavarësisht prej synimeve të mëdha që ka Feronikeli në ndeshjen ndaj Dukagjinit, Mark Milicaj është optimist se skuadra nga Klina do të nxjerrë rezultat pozitiv nga kjo ndeshje. "Në ndeshjen e radhës do të përballemi me Feronikelin. Do të jetë një ndeshje shumë e vështirë pasi Feronikeli është në formë të mirë çka dëshmoi edhe në ndeshjen e Kupës ndaj Ballkanit dhe në kampionat kundër Vushtrisë, por besojmë se me një angazhim maksimal nga të gjithë futbollistët mund të marrim rezultat pozitiv", ka thënë Milicaj



do ta ruajë përgjatë gjithë jetës. "Kam qenë pjesë e Feronikelit vite më parë dhe kam kaluar shumë mirë. Nëse i shënoj gol, normalisht se do të gëzohem, por kjo nuk do të thotë se kam humbur respektin për këtë skuadër", ka shtuar Milicaj. Skuadra e Dukagjinit

pozicionohet në pozitën e fundit me vetëm dhjetë pikë, kurse Feronikeli pozicionohet në pozitën e pestë me 37 pikë të grumbulluara. Për ndeshjen që zhvillohet në kuadër të javës së 24-t në elitë, ka folur edhe mesfushori Albert Dabiqaj. Ky i fundit ka paralajmëruar fitore në

këtë ndeshje. "Kundërshtari i radhës është në pozitën e fundit, por ka një skuadër të mirë. Ne shkojmë për fitore dhe besoj se do t'ia arrijmë këtë qëllim", ka thënë Dabiqaj. Sot (e premte) zhvillohet ndeshja në mes të Flamurtarit dhe Ballkanit, e cila, po ashtu, fillon nga ora 17:00.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

Prishtinë, 11 qershor - Skuadra e fundit në renditjen tabelore të IPKO Superligës në futboll, Dukagjini, është e gatshme që në ndeshjen që zhvillohet sot (e premte) do të nxjerrë rezultat pozitiv kundër Feronikelit. Mark Milicaj ka thënë për "Epokën e re" se "Nikli" është duke kaluar nëpër një formë të mirë, por fitoren e ka të pamundur në Klinë. "Në ndeshjen e radhës do të përballemi me Feronikelin. Do të jetë një ndeshje shumë e vështirë pasi Feronikeli është në formë të mirë çka dëshmoi edhe në ndeshjen e Kupës ndaj Ballkanit dhe në kampionat kundër Vushtrisë, por besojmë

se me një angazhim maksimal nga të gjithë futbollistët mund të marrim rezultat pozitiv", ka thënë Milicaj, i cili ka bërë me dije se synon që t'i shënojë ish-skuadrës së tij.

Anëtori i njohur në futbollin e Kosovës ka konfirmuar se respektin për klubin nga Drenasi

**IPKO Superliga - Java e 24-t**

**Të premten takohen:**  
17:00 Dukagjini - Feronikeli  
17:00 Flamurtari - Ballkani

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Vushtrria - Prishtina  
17:00 Llapi - Drenica

**Të dielën takohen:**  
17:00 Trepça '89 - Drita  
17:00 Ferizaj - Gjilani

## Rashani: Ëndërroj me Kosovë kualifikimin në Evropian



PRISHTINË, 11 QERSHOR - Futbollisti Elbasan Rashani ka thënë se është i gatshëm në çdo çast ta ndihmojë ekipin e Përfaqësueses së Kosovës. Edhe pse iu dha rasti më pak për të luajtur, sa herë që e kishte mundësinë, e ka dhënë kontributin e vet. Pa dyshim goli i tij në fitoren e "Dardanëve" ndaj Bullgarisë në udhëtim do të mbetet i paharrueshëm. 27-vjeçari tash synon që të arrijë suksese me "Verdhekaltrit" dhe

nuk e fsheh ëndrrën e kualifikimit në "Euro 2020". "Me Kosovën i kam shënuar disa gola. Edhe pse nuk kam luajtur shumë, mendoj se e kam dhënë kontributin tim. E kam marrë një rol 'xhokeri' atje, por e kam pranuar këtë. Kjo nënkupton se në ata minuta që kam luajtur, kam dhënë kontribut", ka thënë Rashani për mediat norvegjeze. "Jam mjaft i lumtur që po mund të kontribuoj për vendin tim. Është një ndjenjë speciale të

luash ndeshje ndërkombëtare. Shpresojmë që të rifillojmë sa më shpejt të luajmë me ekipin kombëtar. I kemi disa ndeshje përpara. Jemi vetëm dy lojë afër kualifikimit në evropian. Do të ishte momenti i ngritjes së karrierës sime", ka shtuar Rashani, i cili aktualisht është pjesë e ekipit norvegjez, Odd. Ai nuk e di nëse do të largohet gjatë verës apo jo. Vedat Muriqi ia kishte propozuar Rashanin ekipit të tij, Fenerbahçe.

## Kryetari i FBK-së ftohet në videokonferencën e dytë nga FIBA Europe

Prishtinë, 11 qershor - FIBA Europe më 17 qershor nga ora 10:00 do ta organizojë videokonferencën e dytë për gjendjen e basketbollit, në këtë kohë të pandemisë me Covid-19. Në adresë të FBK-së ka ardhur ftesa nga FIBA Europe, në emër të kryetarit të FIBA Europe, Turgay Demirel dhe

zëvendëskryetarit John Goncalves, përgjegjës për federatat evropiane të renditura 33-50 në renditjen e Evropës. Qëllimi i kësaj videokonference është ta vazhdojë vlerësimin e situatës aktuale që prek të gjitha Federatat Kombëtare Evropiane si rezultat i krizës Covid-19. Në fund të muajit prill, kryetari i

Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, kishte marrë pjesë në një videokonferencë me kryetarin e FIBA Europe, Turgay Demirel, nënkryetearët Jean Pierre Siutat, Carmen Tocala dhe John Goncalves, si dhe krerët e disa Federatave Nacionale. "Fetahu kishte raportuar mbi situatën

aktuale në basketbollin vendor, anulimin dhe suspendimin e garave, problemet aktuale dhe potenciale me të cilat do të përballen aktorët në sferën e basketbollit, si dhe paraqiti idetë e tij lidhur me përkrahjen e mundshme nga organizata botërore e basketbollit gjatë fazës së rimëkëmbjes nga efekti



i pandemisë së krijuar me Covid-19", thuhet në njoftimin e FBK-së.



## Moto GP zyrtarizon kalendarin me 13 gara, të gjitha në Evropë

VALENCIA, 11 QERSHOR - Moto GP ka paraqitur kalendarin e sezonit 2020. Në kalendarin e publikuar nga Dorna (kompania që menaxhon garat e motoçiklizmit) janë 13 gara të gjitha në Evropë. Sezioni do të nisë më 19 korrik në

Spanjë, në pistën e Jerezit, ku do të zhvillohen dy gara (19 dhe 26 korrik). Nga dy gara do të zhvillohen edhe në pistën austriake të Zeltwegut, atë të Misanos (San Marino), Aragon dhe Valencia (Spanjë). Sezioni do të përfundojë më 15 nëntor,

ndërkohë që nuk dihet ende fati i garave jashtë Evropës për shkak të koronavirusit. Kalendarin 2020 të Moto GP: 19 dhe 26 korrik në Jerez (Spanjë), 9 gusht në Brno (Republika Çeke), 16 dhe 23

gusht në Zeltweg (Austri), 13 dhe 20 shtator në Misano (San Marino), 27 shtator në Montmelo (Spanjë), 11 tetor në Le Mansh (Francë), 18 dhe 25 tetor në Aragon (Spanjë), 8 dhe 15 nëntor në Valencia (Spanjë).



## Berisha: Liga Kosovë - Shqipëri, ëndërr e realizuar për shqiptarët

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Pandemia Covid-19 ka bërë që të anulohen shumë aktivitete sportive në Kosovë, por edhe në botë. Për lojtarët është shumë e rëndësishme që të ruhet forma fizike dhe të stërvitin në këtë kohë. Në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së, kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, ka folur për stërvitjet personale, edicionin e ri, Ligën e Përbashkët Kosovë - Shqipëri dhe ndeshjet e Kosovës A. "Kjo situatë nuk ka qenë aspak e zakonshme për ne lojtarët. Megjithatë, forma fizike është shumë e rëndësishme dhe jam munduar të stërvitem në kushte shtëpiake dhe në ambient të hapur. U bëj apel të gjithë lojtarëve/eve që të mos ndalen", është shprehur në fillim Berisha.

Basketbollisti pejan shton se Liga e Përbashkët Kosovë - Shqipëri është shumë e mirëpritur. "Sigurisht se e përkrahim Ligën e Përbashkët ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo është një ëndërr e realizuar për shumë shqiptarë. Besoj se kjo Ligë do të ishte shumë interesante dhe me interes për publikun mbarëshqiptar. Do të kishte rivalitet dhe do të ishte një risi e mirëseardhur për të gjithë ne", nënvizon tutje kapiteni i



Kosovës, i cili ka folur edhe për synimet me "Dardanët". "Kemi filluar shumë mirë me kampanjën për Botërorin 2023 me dy fitore, ndaj Islandës dhe Luksemburgut. Synimi ynë është që të kemi rezultate pozitive në ndeshjet e nëntorit (kundër Sllovakisë dhe Islandës) dhe në shtëpi, në dy ndeshjet e fundit të muajit shkurt më 2021, ta sigurojmë kualifikimin për në fazën e ardhshme. Qëllimi është që të përfundojmë në njërin nga dy pozitën e para të grupit tonë. Atmosfera në ekipin e Kosovës ka qenë shumë e mirë dhe shpresoj se kjo do të vazhdojë edhe në grumbullimet dhe ndeshjet e ardhshme që do të kemi.

Natyrisht jemi të motivuar për t'u kualifikuar tutje. Prandaj forma fizike është shumë e rëndësishme tani dhe që të jemi të gatshëm për edicionin e ri", përfundoi Dardan Berisha. Kosova A do të grumbullohet në muajin gusht në Prishtinë, derisa në nëntor do të jetë mysafire e Sllovakisë dhe Islandës. Dy ndeshjet e fundit për dardanët në parakualifikimet evropiane për Botërorin 2023 do të jenë në shtëpi ndaj Luksemburgut dhe Sllovakisë. Kosova është lidere e grupit me dy fitore nga dy ndeshje (4 pikë), kurse pas saj janë Sllovakia dhe Islanda me nga tri pikë dhe Luksemburgu i fundit me dy.

## Vetëm tri klube janë në garë për ta fituar tripletën këtë sezon

MUNCHEN, 11 QERSHOR - Bayern Muncheni arriti që të siguronte një biletë për në finalen e Kupës së Gjermanisë, pasi fitoi ndaj Frankfurtit 2-1 në gjysmëfinale. Skuadra "bavareze" i bashkoi Juventusit dhe Paris Saint-Germainit në klubin e ekipeve të vetme që mund të fitojnë tripletën trofesh këtë sezon. Barcelona e as Real Madridi nuk janë në garë për të fituar tre trofe, pasi janë eliminuar në Kupën e Mbretit. Në Angli Manchester City nuk ka shanse për ta fituar kampionatin, ndërkohë që Liverpools është eliminuar nga FA Cup dhe Liga e Kampionëve. Juventusit, PSG-ja dhe Bayern Muncheni kanë shanse që të fitojnë tre trofetë e rëndësishëm këtë sezon. Napoli është në garë për momentin në tri kompeticionet, po shanset për triumfin e mundshëm në Seria A janë shumë minimale. PSG-ja fitoi në tavolinë Ligën 1



prej pandemisë së Covid-19, ndërkohë që nuk ka një vendim zyrtar për finalen e Kupës së Francës, të cilën duhet ta luajë ndaj Saint-Etienne. Juventusit do të luajë në gjysmëfinalen e

Kupës së Italisë kundër Milanit (ka fituar 1-0 në Milano), ndërkohë që në Ligën e Kampionëve duhet ta përmbysin humbjen 1-0 në Francë.

### SHKURT

#### Ibra: Nuk është më ky Milani im

E ardhmja e Zlatan Ibrahimoviçit është një nga dilemat më të mëdha të Milanit për sezonin e ardhshëm. Sulmuesi suedez ka konfirmuar se situata në ekipin kuqezin nuk është aspak e mirë. "Nuk është më Milani im, nuk ka asnjë projekt. Nëse unë jam këtu, është vetëm për pasion". Suedezi është mërziur nga shkarkimi i Zvonimir Bobanit, i cili ndikoi në kthimin e tij te kuqezinjtë. Lidhja shpirtërore e suedezit me Milanin është e fortë, por sulmuesi nuk ka gjasa të mbetet me Milano në këtë situatë. Në një takim të bërë së fundmi me klubin, drejtuesi i lartë i klubit, Gazdis, ka prekur edhe temën e trajnerit, duke ripërsëritur se asgjë nuk është e vendosur.

#### Comani e mirëpret Sanen në Bayern

Kingsley Coman nuk është aspak i shqetësuar nga zërat e merkatos që e çojnë Leroy Sanen te Bayern Munchen. Francezi e sheh mbërritjen e mundshme të Sanes si kërcënim për pozicionin e tij, përkundrazi, ai shprehet se do të luftojë fort për të pasur një vend në formacion. "Nëse vjen Sane, nuk do të jetë problem. Do të ishte problem për mua nëse klubi do të më thoshte se nuk jam më i nevojshëm. Por unë mendoj se klubi i di cilësitë e mia", ka thënë Coman për "Bild".

#### Major League Soccer rifillon më 8 korrik

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë vendi më i prekur nga koronavirusi me më shumë se 2 milionë raste dhe me rreth 115 mijë të vdekur deri tani, megjithatë edhe në ShBA futbollit do të rifillojë. Zyrtarisht Major League Soccer do ta nisë muajin e ardhshëm me ndeshjet e para të sezonit të ri që do të luhen pa tifozë. Në momentin e ndërprerjes në mars ishin luajtur vetëm 2 raundet e para. Kampionati do të fillojë më 8 korrik dhe do të përfundojë aktivitetin më 11 gusht me një format të ri dhe të shkurtuar. Të gjitha takimet do të zhvillohen në kompleksin "Disney World" në Florida. Lajmi i madh u dha nga komisionari i Major League Soccer, Don Garber.

#### Lazio, afër marrëveshjes së re me Inzaghin

Simone Inzaghi është në krye të Lazios që prej vitit 2016 dhe pritet që të nënshkruajë një tjetër kontratë të re, që do ta mbajë atë në kryeqytetin e Italisë deri në verën e vitit 2023. Sipas asaj që shkruan "Il Messagero", Claudio Lotito po punon për detajet e kontratës së re. Raportohet se paga e Inzaghit në kontratën e re do të jetë 2.5 milionë euro në sezon, ndërkohë që në rast se Lazio fiton titullin kampion këtë sezon, atëherë do të përfitojë 3 milionë euro. Kjo do të jetë një nga klauzolat e kontratës së re dhe mendohet se ka mbetur vetëm zyrtarizimi i marrëveshjes.

#### Sarri: Gara për 'Scudetto', e hapur

Trajneri i Juventusit, Mauricio Sarri, pretendon se nuk ka favorit në garën për "Scudetto" në Serinë A pasi, sipas tij, të gjitha skuadrat rrezikojnë të humbin pikë. Me 12 ndeshje të mbetura dhe një pikë që ndan dy të parët, Juventusin dhe Lazion, trajneri i "Bianconerëve", ka thënë se gara e për "Scudetto" është e hapur. Interi është nëntë pikë pas liderëve të ligës Juventusit, por mund ta mbyllë hendekun në gjashtë pikë nëse ata fitojnë lojën e tyre të mbetur. Kështu, Sarri ka deklaruar se gara pritet të jetë e hapur për titull dhe nuk ka favorit. "Në këtë situatë, ne nuk mund të flasim për favorit për 'Scudetto'. Të gjitha ekipet rrezikojnë të humbin pikë. Gjëja më e rëndësishme është ta përmbysim sezonin dhe nëse situata shëndetësore e lejon atë, ne duhet t'i rishikojmë protokollet dhe ta shmangim karantinën, për të arritur në përfundimin e kampionatit", ka thënë Sarri.



## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Shaban Jashari"  
Komuna: Skënderaj  
Data: 12.06.2020

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/030 - ESIP/SDG/030-G/1.2	Materiale Didaktike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Shaban Jashari" Skënderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Paisja dhe furnizimi i kabinetit të Ed. Muzikore me vegla e mjete muzikore
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku një kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Shaban Jashari" Skënderaj më së largu deri më 22.06.2020.
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues: Rushit Jeta  
E-maili: [rushitjeta@hotmail.com](mailto:rushitjeta@hotmail.com)  
Telefoni: 044-181-427

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Ahmet Delia"  
Komuna: Skënderaj  
Data: 12.06.2020

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/032 - ESIP/SDG/032-G/1.2	Materiale Didaktike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Ahmet Delia" Skënderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Pajisje laboratorike për kabinetet:
    - Biologji
    - Kimi
    - Fizikë
    - Matematikë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku një kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Ahmet Delia" Skënderaj më së largu deri më 22.06.2020.
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues: Hyra Tahiraj  
E-maili: [tahirajhyra@gmail.com](mailto:tahirajhyra@gmail.com)  
Telefoni: 049 925 170

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Dëshmorët e Qyqavicës"  
Komuna: Skënderaj  
Data: 12.06.2020

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/033 - ESIP/SDG/033-G/1.2	Materiale Didaktike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës" fshati Qirez Skënderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Pajisje laboratorike për kabinetin:
    - Kimi,
    - Fizikë.
    - Matematikë.
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 1 kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës" fshati Qirez Skënderaj më së largu deri më 22.06.2020.
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
Personi kontaktues: Rrahim Derivishaj  
E-maili: [rrahimderivishaj@hotmail.com](mailto:rrahimderivishaj@hotmail.com)

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Shotë Galica"  
Komuna: Skënderaj  
Data: 12.06.2020

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/011 - ESIP/SDG/011-G/1.2	Mjetet Didaktike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Shotë Galica" fshati Runik, Skënderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
  - Pajisje laboratorike për kabinetin:
    - Biologji,
    - Kimi,
    - Gjeografi.
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
  - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku një kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme dy vitet e fundit;
  - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: SHFMU "Shotë Galica" fshati Runik, Skënderaj më së largu deri më 22.06.2020.
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.



## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Abidin Rexha"  
 Komuna: Skënderaj  
 Data: 12.06.2020

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/034-G/1.1	Materiale Didaktike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës: SHFMU "Abidin Rexha" fshati Turiçec, Skënderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Pajisje laboratorike për kabinetin:
- Biologji,
- Kimi,
- Fizikë,
- Matematikë.

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku një kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme:
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

## 3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës: SHFMU "Abidin Rexha" fshati Turiçec, Skënderaj më së largu deri më 22.06.2020.

## 4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
 Personi kontaktues: Fadil Beqa  
 E-maili: [fad\\_beqa@live.com](mailto:fad_beqa@live.com)  
 Telefoni: 049-288-334

## Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Azem Bejta"  
 Komuna: Skënderaj  
 Data: 12.06.2020

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/C1.3/029 - ESIP/SDG/029-G/1.2	Materiale Didaktike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës: SHFMU "Azem Bejta" fshati Prekaz i Epërm, Skënderaj. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

## 1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Pajisje laboratorike per kabinetet:
- Fizikë,
- Biologji.
- Kimi.

## 2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku një kontrate për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme dy vitet e fundit:
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

## 3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës: SHFMU "Azem Bejta" fshati Prekaz i Epërm, Skënderaj më së largu deri më 22.06.2020.

## 4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:  
 Personi kontaktues: Jashar Jashari  
 E-maili: [jashar.200@gmail.com](mailto:jashar.200@gmail.com)

**Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Loma Family" Sh.p.k Gorazhdec, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:**

**DEBAT PUBLIK**

**Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës për përpunim dhe konservim te mishit në Gorazhdec komuna e Pejës.**

**Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.07.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Ujëvara e Drinit" në Radafc komuna e Pejës do të organizohet debat publik nga kompania "Loma Family" Sh.p.k Gorazhdec, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.**

**Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës për përpunim dhe konservim te mishit në Gorazhdec komuna e Pejës.**

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.**

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Që nga data 07.05.2020, "MBC" me seli në Vushtrri bënë njoftimin për zvogëlim të kapitalit themeltar të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

► Fisnik Sertolli shpall te pavlefshme deftesat diplomen certifikaten shmlt "11 Marsi" Prizren

► Besnik Brahaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf "Zenun Çoça" Gjonaj

► Ardian Maloku shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf "Haziz Tolaj" Jeta E Re

► Kastriot Morina shpall te pavlefshme deftesat e vitit I, II, III shmlt "11 marsi" Prizren

► Alban Maliku shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf "Haziz Tolaj" Jete e Re

► Lëshoj banes me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banes me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banes me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188





Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

## KONKURS

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve hap konkurs për ekspertë me marrëveshje për shërbime të veçanta në pozitat si ne vijim:

1. Ekspert të sigurimit të cilësisë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP)
2. Ekspert për trajnim të ofruesve që zbatojnë Njohjen e Mësimi Paraprak (NjMP)
3. Ekspert për trajnim të ekipeve vlerësuese në procesin e akreditimit të institucioneve për zbatimin e NjMP-së
4. Ekspert për hartimin e rregullores së brendshme për aplikim në proceset e AKK

Kandidatët për pozitën ekspert të sigurimit të cilësisë të IAAP duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë kualifikim të arsimit të lartë;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në arsim, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë përfunduar trajnime për vlerësim, zhvillim të kurrikulit, zhvillim të programeve;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë përkatëse,
- Shqyrtojnë aplikacionet dhe gjithë dokumentacionin e ofruesve të AAP për akreditim të institucioneve,
- Realizojnë vizita në terren,
- Bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të panelit, diskutojnë dhe harmonizojnë qëndrimet e tyre,
- Kontribuojnë në përgatitjen e një raporti që përcakton të gjeturat (gjetjet) dhe rekomandimet në lidhje me akreditimin e institucioneve,
- I raportojnë Drejtorit të AKK.

Kandidatët për pozitën ekspert për trajnim të ofruesve që zbatojnë NjMP dhe ekspert për trajnim të ekipeve vlerësuese për NjMP duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë kualifikim të arsimit të lartë;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në arsim, trajnim, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë njohuri në proceset e NjMP;
- Të kenë përfunduar trajnime për vlerësim, zhvillim të kurrikulit, zhvillim të programeve;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë përkatëse;
- Bashkëpunojnë me personelin e AKK;
- Hartojnë dhe prezantojnë materialet për trajnim;
- Zhvillojnë seanca trajnime;
- Hartojnë raporte pune.

Kandidatët për pozitën ekspert për hartimin e rregullores së brendshme për aplikim në proceset e AKK duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë kualifikim të arsimit të lartë;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në administratë publike, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë njohuri rreth procesit të akreditimit dhe validimit;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë përkatëse;
- Shqyrtojnë dokumentet egzistuese të AKK, si dhe dokumentet tjera ligjore në fuqi;
- Mbështesin dhe ndihmojnë AKK në harmonizimin (hartimin e draftit final) të rregullores së brendshme me dokumentet tjera dhe legjislacionin në fuqi për aplikim në proceset e AKK;
- Bashkëpunojnë me personelin e AKK;
- Hartojnë raporte pune.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kushtet, ti paraqesin dokumentet si në vijim:

- CV në formatin europass;
- Diplomat dhe certifikatat;
- Referencat

Dokumentet që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e lartëcekura nuk do të shqyrtohen. Aplikimi bëhet vetëm në formë elektronike në këtë adresë donjeta.n.gashi@rks-gov.net.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve,

Rr. Agim Ramadani p.n, Qendra e Studentëve, Prishtinë.

Tel: 038- 212 595

Afati i aplikimit: Nga data 12.06.2020 deri më 25.06.2020.

Për më shumë klikoni: [www.akks.rks-gov.net](http://www.akks.rks-gov.net)



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

## KONKURS

Nacionalni Autoritet za Kualifikacije raspisuje konkurs za eksperte Sporazum za posebne usluge za sledeće pozicije:

1. Ekspert za obezbeđivanje kvaliteta u Institucijama za profesionalno obrazovanje i osposobljavanje (IPOO)
2. Ekspert za obuku pružatelja usluga koji primenjuju Priznavanje prethodnog učenja (PPU)
3. Ekspert za obuku ekipe za ocenjivanje u procesu akreditacije institucija za implementaciju PPU-a
4. Ekspert za izradu interne regulative za primenu u procesima NAK-a.

**Kandidati za poziciju Ekspert za obezbeđivanje kvalitete IPOO moraju ispunjavati sledeće uslove:**

- Da ima kvalifikaciju visokog obrazovanja;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u obrazovanju, menadžiranju ili slično;
- Da je završio obuke za procenu, razvoj kurikuluma, razvoj programa;
- Da ima znanje o informacionoj tehnologiji.

Zadaci i odgovornosti

- Eksperti koji budu izabrani potpisa će relevantna ugovor,
- Razmatraju aplikacije i svu dokumentaciju onih koji omogućavaju POO-a za akreditaciju institucija,
- Obavlja posete na terenu,
- Saraduje sa ostalim članovima panela, razgovaraju i usklađuju svoje stavove,
- Doprinosu u pripremi izveštaja koji definiše nalaze (nalazi) i preporuke u vezi akreditacije institucija,
- Izveštavaju direktorijatu NAK.

**Kandidati za poziciju ekspert za obuku ponuđače koji primenjuju PPU i ekspert za obuku procenjivačkih ekipe PPU moraju ispunjavati sledeće uslove:**

- Da ima kvalifikaciju visokog obrazovanja;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u obrazovanju, menadžiranju ili slično;
- Da je upoznat sa procesima PPU;
- Da je završi obuku za procenu, razvoj kurikuluma, razvoj programa;
- Da imati znanje o informacionoj tehnologiji.

Zadaci i odgovornosti

- Eksperti koji budu izabrani će potpisati dotični ugovor,
- Saraduju sa osobljem NAK;
- Sastavljaju i predstavljaju materijal za obuku;
- Održavaju seanse obuke;
- Sastavljaju radne izveštaje.

**Kandidati za poziciju ekspert za izradu interne regulative za primenu procesa NAK moraju ispunjavati sledeće uslove:**

- Da ima kvalifikaciju visokog obrazovanja;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u javnoj administraciji, menadžiranju ili slično;
- Da ima osnovno znanje u vezi procesa akreditacije
- Da imati znanje o informacionoj tehnologiji.

Zadaci i odgovornosti

- Eksperti koji budu izabrani će potpisati dotični ugovor,
- Razmatraju postojeća dokumenta NAA, kao i druga važeća zakonska dokumenta;
- Podržavaju i pomažu NAK-u u usklađivanju (sastavljanju konačnog nacrt) interne regulative sa drugim dokumentima i zakonodavstvom na snazi za primenu procesa NAK-a;
- Saraduju sa osobljem NAK;
- Sastavljaju radne izveštaje.

Podstiču se sve zainteresovane strane koje ispunjavaju uslove, da dostave sledeća dokumenta:

- CV u Europas formatu;
- Diplome i certifikati;
- Reference

**Dokumenti koji ne ispunjavaju gore navedene uslove i kriterijume neće biti uzeti na razmatranje.**

**Prijavlivanje se vrši samo u elektronskom obliku na ovoj adresi donjeta.n.gashi@rks-gov.net.**

Nacionalni autoritet za kvalifikacije,

Ul. Agim Ramadani b.b, Studentski centar, Priština.

Tel. 038- 212 595

Rok prijavlivanja: Od dana 12.06.2020 do 25.06.2020

Za više kliknite na: [www.akks.rks-gov.net](http://www.akks.rks-gov.net)





Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

## KONKURS

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve hap konkurs për ekspertë me marrëveshje për shërbimet e veçanta për të punuar me panelet e ekspertëve që ndërmarrin veprimtari për verifikimin e standardeve të profesionit si dhe në procesin e validimit dhe të akreditimit nga:

1. Sektori i energjetikës:  
(Punëtorët e impiantit për gjenerimin e energjisë)
2. Sektori i tekstilit:  
(Punëtorët e zejës me tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashëm)
3. Sektori i prodhimitarisë:  
(Nëpunës i prodhimit (përpunimit))
4. Sektori i përpunimit:  
(Prodhuesit e tapicerive (sfungjerëve) dhe të ngjashëm)
5. Sektori i turizmit:  
(Teknik/e për hotele-restorante)

### Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të kenë kualifikim përkatës të arsimit të lartë;
- Të jenë të kualifikuar dhe të kenë përvojë profesionale së paku 10 vite në fushën përkatëse;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në arsim, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë përfunduar trajnime për vlerësim, zhvillim të kurrikulit, zhvillim të programeve;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë përkatëse,
- Shqyrtojnë aplikacionet dhe gjithë dokumentacion e ofruesve të AAP për akreditim të institucioneve,
- Realizojnë vizita në terren,
- Bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të panelit, diskutojnë dhe harmonizojnë qëndrimet e tyre,
- Kontribuojnë në përgatitjen e raportit që përcakton të gjeturat (gjetjet) dhe rekomandimet në lidhje me akreditimin e institucioneve,
- I raportojnë Drejtorit të AKK.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kushtet, ti paraqesin dokumentet si në vijim:

- CV në formatin europass;
- Diplomat dhe certifikatat;
- Referencat

Dokumentet që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e lartëcekura nuk do të shqyrtohen.

Aplikimi bëhet vetëm në formë elektronike në adresën [donjeta.n.gashi@rks-gov.net](mailto:donjeta.n.gashi@rks-gov.net).

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve,

Rr. Agim Ramadani p.n, Qendra e Studentëve, Prishtinë.

Tel: 038- 212 595

Afati i aplikimit: Nga data 12.06.2020 deri më 25.06.2020.

Për më shumë klikoni: [www.akkks.rks-gov.net](http://www.akkks.rks-gov.net)



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

## KONKURS

Nacionalni Autoritet za Kualifikacije raspisuje konkurs za Sporazume za posebne usluge za rad sa ekspertskim panelima koji preuzimaju aktivnosti za Verifikacija standarda profesije kao i u procesu validacije i akreditacije iz:

1. Sektor energetike:  
(Radnici postrojenja za proizvodnju električne energije)
2. Sektor za tekstil:  
(Radnici znata za tekstil, kože i sličnim materijalima)
3. Proizvodni sektor:  
(Službenik za proizvodnju (preradu))
4. Sektor za preradu:  
(Proizvođači presvlaka (spužve) i slično)
5. Sektor turizma:  
(Tehničar za hotele restorane)

### Kandidati moraju ispunjavati sledeće uslove:

- Da ima kvalifikaciju visokog obrazovanja;
- Da je kvalifikovan i da ima profesionalno iskustvo najmanje 10 godina u dotičnoj oblasti;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u obrazovanju, menadžiranju ili slično;
- Da je završi obuku za procenu, razvoj kurikuluma, razvoj programa;
- Da poseduje znanje o informacionoj tehnologiji.

### Zadaci i odgovornosti

- Eksperti koji budu izabrani će potpisati relevantna ugovor,
- Razmatraju aplikacije i svu dokumentaciju ponuđačima POO-a za akreditaciju institucija,
- Obavljati posete na terenu,
- Suradujte s ostalim članovima panela, razgovaraju i uskladuju svoje stavove,
- Doprinos u pripremi izveštaja koji definiše nalaze (nalazi) i preporuke u vezi akreditacije institucija,
- Izveštavaju direktorijati NAK.

Podstiču se sve zainteresovane strane koje ispunjavaju uslove, da dostave sledeća dokumenta:

- CV u Europas formatu;
- Diplome i certifikati;
- Reference

Dokumenti koji ne ispunjavaju gore navedene uslove i kriterijume neće biti uzeti na razmatranje.

Prijavlivanje se vrši samo u elektronskom obliku na adresi [donjeta.n.gashi@rks-gov.net](mailto:donjeta.n.gashi@rks-gov.net).

Nacionalni autoritet za kvalifikacije,

Ul. Agim Ramadani b.b, Studentski centar, Priština.

Tel. 038- 212 595

Rok prijavlivanja: Od dana 12.06.2020 do 25.06.2020

Za više kliknite na: [www.akkks.rks-gov.net](http://www.akkks.rks-gov.net)



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Dhf Company” Sh.p.k Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:


### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.07.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant të kompanisë “Dhf Company” i cili gjendet në anën e majtë të rrugës Deçan-Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania “Dhf Company” Sh.p.k Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Deçan.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**MEKA**  
HALAL FOOD

**PASHTETË PULE**

gluten free

100% mish pule

*cilësi e garantuar*

pa konservues